



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.45

1 prill

2008

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9889 datë 20.3.2008	Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” 2029	2029
Ligj nr.9890 datë 20.3.2008	Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar 2031	2031
Ligj nr.9891 datë 20.3.2008	Për ratifikimin e ndryshimit të “Marrëveshjes së rishitjes së aksioneve të INSIG sh.a.-së, ndërmjet Ministrisë së Financave, që vepron në emër të shtetit shqiptar, Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)” 2038	2038
Ligj nr.9892 datë 20.3.2008	Për një ndryshim në ligjin nr.9649, datë 27.11.2006 “Për përcaktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të INSIG sh.a.-së” 2039	2039
Vendim i Kuvendit nr.174, datë 20.3.2008	Për miratimin e raportit për veprimtarinë vjetore të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit 2040	2040
Vendim i Kuvendit nr.175, datë 27.3.2008	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkim ministri 2040	2040
Vendim i Kuvendit nr.176, datë 27.3.2008	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkim zëvendëskryeministri 2041	2041
Vendim i Kuvendit nr.177, datë 27.3.2008	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërim ministri 2041	2041

Vendim i GJK nr.9, datë 19.3.2008	Me objekt: 1. Shfuqizimin e fjalisë së tretë të pikës 1 të nenit 23 dhe pikave 2 dhe 3 të nenit 64 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. 2. Pezullimi i zbatimit të dispozitave të ligjit, objekt i kësaj kërkesë, deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.....	2042
Vendim i GJK nr.10, datë 19.3.2008	Me objekt shfuqizimin e nenit 2, pika 3, të ligjit nr.9744, datë 28.5.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, i ndryshuar, si i papajtueshëm me Kushtetutën.....	2048
Vendim i ERE nr.12, datë 28.1.2008	Për miratimin e kohëzgjatjes për faturimin aforfe për abonentët familjarë pa matës të energjisë elektrike.....	2059
Vendim i ERE nr.33, datë 21.3.2008	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë HERA sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues (Parku Eolik “Projekti KAPPET”), si burim i rinovueshëm energjie ...	2961
Vendim i ERE nr.34, datë 21.3.2008	Për fillimin e procedurave për miratimin e rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike	2061
Vendim i ERE nr.35, datë 21.3.2008	Për fillimin e procedurave për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave për kompaninë publike të gjenerimit, metodologjisë së llogaritjes së tarifave për furnizuesin publik me shumicë të energjisë elektrike, metodologjisë së llogaritjes së tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe metodologjisë së llogaritjes së tarifave për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike	2062
Vendim i ERE nr.36, datë 21.3.2008	Për fillimin e procedurave për miratimin e marrëveshjes tip mes furnizuesit publik me shumicë dhe furnizuesit publik me pakicë.....	2062
Vendim i ERE nr.37, datë 21.3.2008	Për fillimin e procedurës për rishikimin e rregullores së procedurave të licencimit	2063
Vendim i ERE nr.38, datë 21.3.2008	Për fillimin e procedurës për një shtesë në vendimin nr.46, datë 10.8.2007 “Për përcaktimin e vlerës së gjobave dhe llogaritjes së dëmit që do të aplikohen ndaj klientëve me kundërvajtje në përdorimin e energjisë elektrike”.....	2063
Vendim i ERE nr.39, datë 21.3.2008	Për fillimin e procedurave për miratimin e licencës së furnizimit publik me shumicë të energjisë elektrike, licencës së shpërndarjes së energjisë elektrike dhe licencës së furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike	2064
Vendim i ERE nr.40, datë 24.3.2008	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “HEC i Terviolit” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe prodhimit të energjisë elektrike.....	2064

Kërkesë e MMPPTT
nr.2207/1, datë 24.3.2008

Për shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor Fier-Ballsh-Tepelenë (Povla 2).....	2065
Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Neim Braho	2065

LIGJ
Nr.9889, datë 20.3.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE TË STRUKTURËS SË FORMULËS SË
PRIVATIZIMIT TË SHOQËRISË ANONIME “OPERATORI I SISTEMIT TË
SHPËRNDARJES”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij ligji është të përcaktojë formën dhe formulën e privatizimit të shoqërisë anonime “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes”, në vijim OSSH, sha.

Neni 2
Forma e privatizimit

Privatizimi i OSSH, sha-së realizohet nëpërmjet transferimit të aksioneve, të zotëruara nga shteti, si aksione të kapitalit të shoqërisë, një investitori strategjik, me procedurën “Tender i hapur ndërkombëtar”, sipas formulës së privatizimit, të parashikuar në këtë ligj.

Neni 3
Formula e privatizimit

Forma dhe formula e privatizimit të aksioneve të OSSH, sha-së janë si më poshtë:

1. Jo më pak se 51 për qind, por jo më shumë se 76 për qind e aksioneve të kapitalit u ofrohen investitorëve strategjikë, të cilët janë shoqëri apo bashkim shoqërish, që zotërojnë garanci të nevojshme financiare dhe janë të specializuara në sektorin e energjisë. Paketa e aksioneve të parashikuara në paragrafin e mësipërm transferohet nëpërmjet shitjes, me procedurën “Tender i hapur ndërkombëtar”. Çmimi i blerjes paguhet në euro. Madhësia e kësaj pakete përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Paketa e mbetur e aksioneve të kapitalit të shoqërisë anonime “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes”, të zotëruara nga shteti, u ofrohet subjekteve të mëposhtme:

a) ish-subjekteve të shpronësuara të truallit dhe të ndërtesave, në vlerë të barabartë me vlerën e truallit dhe/apo ndërtesave, të vlerësuara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet;

b) punonjësve të OSSH, sha-së, në shkëmbim të aksioneve me bonot e privatizimit apo letrat me vlerë për të persektuarit, të zotëruara prej tyre, përfshirë edhe ato të zotëruara nga prindërit, bashkëshorti/ja dhe fëmijët e punonjësve.

Në rast se përqindja e aksioneve të kapitalit të shoqërisë anonime “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” nuk është e mjaftueshme për të kompensuar ish-subjektet e shpronësuara të truallit dhe të ndërtesave, ngarkohet Këshilli i Ministrave për të përcaktuar mënyrën e kompensimit të tyre.

Përqindja, mënyra dhe koha e transferimit të aksioneve, që do t’u ofrohen ish-subjekteve të shpronësuara dhe punonjësve, sipas pikës 2 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Për qëllim të shkronjës “b” të pikës 2 të këtij neni, punonjës të shoqërisë vlerësohen punonjësit, që punojnë në OSSH, sha pas përfundimit të privatizimit dhe/ose që pas vitit 1992 kanë

punuar për të paktën 5 vite për KESH, sha-në dhe/ose për OSSH, sha-në, apo për ndonjërin nga filialet e tyre ose kanë qenë anëtarë të organeve drejtuese të KESH, sha-së apo OSSH, sha-së.

4. Investitorët strategjikë, të cilët kanë blerë aksionet, sipas pikës 1 të këtij neni, ushtrojnë të drejtën e parablerjes së aksioneve të mbetura të OSSH, sha-së, të cilat nuk u janë transferuar ish-subjekteve të shpronësuar të truallit dhe/apo të ndërtesave dhe punonjësve të OSSH, sha-së, sipas pikës 2 të këtij neni, duke paguar të njëjtin çmim për aksion, sipas kontratës së shitjes. E drejta e parablerjes shuhet 1 vit pas përfundimit të procedurës së transferimit të aksioneve, që u janë ofruar subjekteve, sipas pikës 2 të këtij neni.

5. Pas përfundimit të periudhës së të drejtës së parablerjes, aksionet e mbetura të pablera nga investorët strategjikë mbeten në pronësi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, që përfaqëson shtetin. Mënyra e transferimit dhe subjektet, të cilëve do t'u transferohen këto aksione, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në kuptim të këtij paragrafi, nuk zbatohen nenet 206 e 207 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".

Neni 4

Programi i punonjësve të ristrukturuar nga privatizimi

Trajtimi i punonjësve, që do të dalin të papunë nga procesi i ristrukturimit, në kuadër të privatizimit të OSSH, sha-së, si dhe burimet financiare, të nevojshme për kompensimin financiar të tyre, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Përdorimi i të ardhurave nga privatizimi

1. Të ardhurat nga privatizimi i OSSH, sha-së do të përdoren për:

a) mbulimin e shpenzimeve për organizimin e procedurave të tenderit dhe për veprimtari të tjera, që nevojiten në procesin e privatizimit;

b) pagesën e tarifës së suksesit shoqërisë së pavarur konsulente, të kontraktuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

c) shpërblimin e komisionit të vlerësimit të ofertave të Komitetit të Konsulencës dhe Transparencës, si dhe të grupit të negocimit, sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave;

ç) trajtimin e punonjësve, që do të dalin të papunë nga procesi i ristrukturimit të OSSH, sha-së, në kuadër të privatizimit të saj.

Pjesa e mbetur kalon në Buxhetin e Shtetit.

2. Masa e përdorimit të të ardhurave nga privatizimi i OSSH, sha-së përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Miratimi i kontratës

Kontrata për shitjen e aksioneve nënshkruhet nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe miratohet nga Kuvendi.

Neni 7

Procedurat e përzgjedhjes së investorit strategjik

Kriteret e përzgjedhjes së investorëve strategjikë dhe kriteret e vlerësimit të ofertave për privatizimin e OSSH, sha-së përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8

Institucioni përgjegjës për procesin e privatizimit

Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me asistencën e shoqërisë

konsulente, për organizimin dhe kryerjen e procesit të privatizimit të OSSH, sha-së, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

Neni 9

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, sipas përcaktimeve të neneve 3, 4, 5 e 7 të këtij ligji, të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore për realizimin e procesit të privatizimit të OSSH, sha-së.

Neni 10

Legjislacioni i përjashtuar

Ky ligj përjashton zbatimin e akteve ligjore të mëposhtme:

- a) të ligjit nr.8006, datë 5.10.1995 “Për miratimin e formulës së mbajtjes së aksioneve në çastin e shitjes së shoqërive, që veprojnë në sektorin e energjisë elektrike”;
- b) të ligjit nr.7963, datë 13.7.1995 “Për privatizimin e sektorit të energjisë elektrike”.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5678, datë 31.3.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ

Nr.9890, datë 20.3.2008

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8934, DATË 5.9.2002 “PËR MBROJTJEN E MJEDISIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen shtesat si më poshtë:

1. Në fund të pikës 18 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Leja mjedisore për veprimtaritë, që përdorin burimet natyrore ose që mund të kenë ndikim negativ në mjedis, lëshohet sipas dispozitave të këtij ligji dhe të ligjeve të tjera të veçanta për mjedisin.”.

2. Pas pikës 18 shtohet pika 18/1 me këtë përmbajtje:

“18/1. “Leja mjedisore e integruar” është leje e mbështetur në më shumë se në një ligj të veçantë mjedisor dhe e lëshuar për veprimtari, që i nënshtrohen parandalimit dhe kontrollit të integruar të ndotjes, sipas nenit 15 të këtij ligji, bazuar në direktivën 96/61/EC, 24.9.1996 “Për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes (IPPC).”.

3. Pas pikës 39 shtohen pikat 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47 dhe 48 me këtë përmbajtje:

“40. “Publik” janë personat fizikë ose juridikë, organizatat jofitimprurëse dhe grupimet e tyre.

41. “Aksident” është dukuri në formë të emisionit të madh, të zjarrit ose të shpërthimit, që ndodh si rezultat i ngjarjeve të pakontrolluara gjatë punës së një veprimtarie, me praninë e një apo më tepër substancave të rrezikshme e që sjell rrezik serioz për jetën e shëndetin e njeriut dhe për mjedisin, menjëherë ose më vonë, në vendin e zhvillimit të veprimtarisë ose jashtë saj.

42. “Rrezik” është cilësia e një substance të rrezikshme ose e një situatë fizike, e aftë të shkaktojë dëme për jetën, shëndetin e njeriut dhe për mjedisin.

43. “Kërcënim” është mundësia për paraqitjen e pasojës së caktuar negative për mjedisin, në periudhë të caktuar kohore ose në rrethana të caktuara.

44. “Ndryshime klimatike” janë ndryshime të shkaktuara nga ndikimet antropogjene në sistemin klimatik, në përputhje me dispozitat e Konventës kuadër të Kombeve të Bashkuara “Për ndryshimet klimatike”, ku Republika e Shqipërisë është palë me ligjin nr.9334, datë 16.12.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kiotos të Konventës kuadër të Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike”.

45. “Mekanizëm për zhvillim të pastër” është njëri nga mekanizmat fleksibël të përcaktuar në nenin 12 të Protokollit të Kiotos, ku Republika e Shqipërisë është palë me ligjin nr.9334, datë 16.12.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kiotos të Konventës kuadër të Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike”.

46. “Biocenoza” është bashkësi llojesh apo shoqërimi i mikroorganizmave, bimëve ose kafshëve, të lidhur me një biotop të caktuar.

47. “Ministër” është ministri që drejton ministrinë përgjegjëse për mjedisin.

48. “Ministria” është ministria përgjegjëse për mjedisin.”.

Neni 2

Kudo në ligj emërtimi “Ministër i Mjedisit” zëvendësohet me emërtimin “ministër” dhe emërtimi “Ministria e Mjedisit” zëvendësohet me emërtimin “ministria”.

Neni 3

Në fund të nenit 4 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Çdo person, që ushtron një veprimtari ligjore, sipas këtij ligji, gjatë zbatimit të detyrave të tij, mban parasysh dhe zbaton parimet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni.”.

Neni 4

Në nenin 8, pika 2 shfuqizohet.

Neni 5

Në nenin 22 bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Në fund të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Importimi i mbetjeve të rrezikshme ndalohet edhe për qëllime përdorimi, përpunimi e riciklimi.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Importimi i mbetjeve të ngurta për t'u përdorur, përpunuar e ricikluar bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas rregullave, procedurave, sasive dhe afateve të miratuara prej tij, me propozimin e ministrit.”.

3. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Me propozimin e ministrit, Këshilli i Ministrave miraton listën e mbetjeve, që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, përpunimi e riciklimi.”.

Neni 6

Pas nenit 25 shtohet neni 25/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 25/1

Kadastra e mjedisit

1. Për të evidentuar ndotjet e dëmtimet e mjedisit dhe të përbërësve të tij, si dhe për të rritur efektshmërinë e masave mbrojtëse e rehabilituese të mjedisit, në Agjencinë e Mjedisit dhe të Pyjeve organizohet kadastra e mjedisit.

2. Kadastra e mjedisit përbën bazën e të dhënave numerike dhe cilësore për ndotësit, burimet e ndotjes e për zonat e ndotura, në bazë të regjistrave dhe të evidencave, diagramave, tabelave e hartave.

3. Në nivel kombëtar, kadastra e mjedisit administrohet nga Agjencia e Mjedisit dhe e Pyjeve, ndërsa në nivel qarku administrohet nga agjencitë rajonale të mjedisit.

4. Rregullat për krijimin dhe administrimin e kadastrës së mjedisit, për regjistrimin, përditësimin dhe ndryshimet në gjendjen e tij, miratohen me udhëzim të ministrit.”.

Neni 7

Në nenin 36, pikat 3 dhe 4 ndryshohen si më poshtë:

“3. Leja mjedisore jepet, hiqet, rishikohet e ndryshohet nga ministri, vetëm në kushtet e parashikuara në këtë ligj.

4. Nëse veprimtaria e pajisur me leje mjedisore nuk fillon brenda dy vjetëve nga data e miratimit të saj, leja bëhet e pavlefshme dhe procedura e aplikimit fillon nga e para.”.

Neni 8

Pas nenit 36 shtohet neni 36/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 36/1

Leja e integruar mjedisore

Leja e integruar mjedisore lëshohet në rast se veprimtaria e propozuar:

a) është e një natyre të tillë, për të cilën kërkohet një leje mjedisore, e mbështetur në legjislacion më të zgjeruar sesa në një ligj të veçantë;

b) i nënshtrohet parandalimit dhe kontrollit të integruar të ndotjes, sipas nenit 17 të këtij ligji.”.

Neni 9

Në nenin 38, pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

“1. Leja mjedisore jepet brenda 2 muajve nga paraqitja e kërkesës dhe është e vlefshme nga koha kur fillon veprimtaria, derisa kushtet, mbi të cilat është dhënë, nuk ndryshojnë.

2. Organi përgjegjës mund ta zgjasë kohën e dhënies së lejes deri në 3 muaj, kur del e nevojshme kryerja e ekspertizave tepër të kualifikuara. Nëse organi që miraton lejen mjedisore nuk jep përgjigje brenda afatit të mësipërm, leja quhet e miratuar.”.

Neni 10

Pas nenit 39 shtohen nenet 39/1 dhe 39/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 39/1

Përmbajtja e lejes mjedisore

Çdo leje mjedisore përmban:

a) një përshkrim të veprimtarisë së lejuar, përfshirë emërtimin, natyrën, vendndodhjen e saj, si dhe hollësitë e çdo shkarkimi të autorizuar nga leja;

- b) të dhëna të mbajtësit të lejes;
- c) kërkesat dhe kushtet e ndërtimit dhe të funksionimit të veprimtarisë së lejuar;
- ç) kërkesat e raportimit, që përfshijnë edhe normat e standardet mjedisore të shkarkimeve;
- d) çdo kusht apo informacion tjetër, sipas këtij ligji, ligjeve të tjera të veçanta mjedisore dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre.

Neni 39/2
Formati i lejes

Lejet mjedisore formatohen në përputhje me llojin e veprimtarive. Format i tyre miratohet nga ministri.”.

Neni 11

Neni 40 shfuqizohet.

Neni 12

Në nenin 41, pika 2 shfuqizohet.

Neni 13

Neni 42 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 42
Transferimi i lejes

1. Leja mjedisore është personale dhe mund të transferohet te një person tjetër fizik ose juridik, kur veprimtaria e pajisur me leje kalon në pronësi apo në përdorim të tij. Transferimi bëhet vetëm me miratimin me shkrim të organit që ka lëshuar lejen, në bazë të kërkesës së të interesuarit, shoqëruar me dokumentet që provojnë kalimin e pronësisë apo të përdorimit.

2. Ndryshimi i administratorit të një personi juridik nuk është shkak për transferimin e lejes mjedisore.”.

Neni 14

Pas nenit 45 shtohet neni 45/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 45/1
Regjistri i lejeve mjedisore

1. Ministria dhe çdo agjenci rajonale mbajnë regjistrin e lejeve mjedisore, formati i të cilit miratohet nga ministri. Në regjistër shënohen të dhëna:

- a) për kërkesat për dhënien e çdo lejeje të re mjedisore, si dhe për ndryshimin apo modifikimin e lejeve të miratuara;
- b) për të gjitha lejet mjedisore të miratuara;
- c) të cilat mbajtësi i lejes ia përcjell agjencisë rajonale të mjedisit, në përputhje me kërkesat e lejes;

ç) për çdo masë të vendosur nga Inspektorati i Mjedisit ndaj veprimtarisë së pajisur me leje.

2. Në një regjistër, që mbahet sipas këtij neni, nuk mund të përfshihet asnjë informacion, që vë në rrezik sigurinë kombëtare apo që e cenon atë.

3. Regjistrat e krijuar dhe të administruar, në përputhje me këtë nen, janë të hapur për konsultim pa pagesë nga publiku, gjatë orarit të zakonshëm të punës dhe administruesi i tij siguron lehtësi për t'i mundësuar publikut të marrë kopje të të dhënave të regjistrit me tarifa të arsyeshme, të miratuara nga ministri.

4. Kërkuesi ose mbajtësi i lejes mund t'i kërkojë ministrisë, që informacioni për lejen mjedisore ose kërkesën për leje të mos shënohet në regjistër ose të mos i jepet publikut kur:

- a) përbën sekret tregtar;
- b) dhënia e tij do t'i shkaktonte atij dëm ose humbje ekonomike.

5. Për të përjashtuar ose jo një informacion nga një regjistër apo për të mos ia dhënë publikut, sipas pikës 4 të këtij neni, administruesi i tij i kërkon operatorit paraqitjen e dokumenteve dhe të fakteve, që provojnë vërtetësinë e dëmit ose të humbjes ekonomike që ai pretendon.

6. Për të përcaktuar nëse një informacion duhet përjashtuar apo jo nga një regjistër, administruesi i tij balancon interesin publik për nxitjen e aksesit ndaj informacionit mjedisor me interesat konkretë të aplikantit.”.

Neni 15

Në nenin 46, shkronja “e” ndryshohet si më poshtë:

“e) njoftimin e agjencive rajonale të mjedisit për rezultatet e vetëmonitorimit dhe, në çdo kohë, për aksidentet ose emergjencat me ndikim negativ në mjedis. Afatet e njoftimit të rezultateve të vetëmonitorimit përcaktohen me urdhër të ministrit, në bazë të llojeve të veprimtarive.”.

Neni 16

Pas nenit 51 shtohet neni 51/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 51/1

Parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes

1. Me propozimin e ministrit, Këshilli i Ministrave miraton listën e veprimtarive, të cilat, për shkak të tendencës së tyre për të shkaktuar dëm mjedisor, do t'i nënshtrohen parandalimit dhe kontrollit të integruar të ndotjes dhe do të pajisen me leje mjedisore të integruar (këtu e tutje referuar si leje IPPC), në përputhje me dispozitat e këtij neni.

2. Kërkesat, dokumentet dhe informacionet që e shoqërojnë, rregullat dhe procedurat për lejet e integruara, si dhe për parandalimin e kontrollin e integruar të ndotjes, sipas direktivës IPPC të KE-së, miratohen me udhëzim të ministrit.

3. Në përcaktimin e një kërkesë për një leje IPPC, ministri mban parasysh këto parime:

- a) marrjen e masave të përshtatshme kundër ndotjes, nëpërmjet zbatimit të teknikave më të mira në dispozicion;
- b) veprimtaria të mos shkaktojë asnjë ndotje të konsiderueshme;
- c) shmangien e gjenerimit të mbetjeve dhe, kur kjo nuk është e mundur, riciklimin e tyre, ose kur kjo është e pamundur nga pikëpamja teknike ose ekonomike, asgjësimin për të shmangur ose ulur ndikimin në mjedis;
- ç) përdorimin me efektivitet të energjisë;

d) marrjen e masave të përshtatshme, për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre;

dh) marrjen masave të nevojshme për ndërprerjen përfundimtare të veprimtarisë, për të shmangur çdo rrezik ndotjeje dhe për ta kthyer vendin e veprimtarive në gjendje të përshtatshme.

4. Për të arritur një nivel shumë të lartë të mbrojtjes së mjedisit në çdo leje IPPC do të parashtrihen këto kushte:

- a) përcaktimin e masave për mbrojtjen e ajrit, ujit dhe tokës;
- b) përdorimin e teknikave më të mira në dispozicion;
- c) vendosjen e standardeve të detyrueshme mjedisore mbi shkarkimet ose, sipas rastit, të parametrave të barasvlefshme ose të masave teknike;
- ç) parashikimin e mbrojtjes së tokës dhe të ujërave tokësore dhe të masave për menaxhimin e mbetjeve;
- d) parandalimin ose minimizimin e ndotjes në distancë të largët ose ndotjes ndërkufitare;
- dh) specifikimin e pajisjeve dhe të procedurave monitoruese, përveç kërkesave të raportimit;

e) informimin nga mbajtësi i lejes të ministrisë për çdo incident ose aksident, që cenon mjedisin në shkallë të konsiderueshme.”.

Neni 17

Në nenin 57, pika 3 shfuqizohet.

Neni 18

Në nenin 66 shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) miraton udhëzime dhe rregullore për zbatimin në praktikë të projekteve për mekanizmat e zhvillimit të pastër, sipas dispozitave të Protokollit të Kiotos.”.

Neni 19

Në nenin 69, titulli dhe pikat 1 e 2 ndryshohen si më poshtë;

“Rrjeti i agjencive të mjedisit

1. Në përbërje të ministrisë funksionon rrjeti i agjencive të mjedisit, si organe të specializuara për monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit. Ai përbëhet nga Agjencia e Mjedisit dhe e Pyjeve, si organ qendror dhe nga agjencitë rajonale të mjedisit, që veprojnë në nivel qarku. Rrjeti i agjencive të mjedisit është në varësi të ministrit.

2. Në zbatim të përparësive dhe të objektivave të ministrisë, rrjeti i agjencive kryen këto detyra:

a) organizon dhe drejton zbatimin e programit vjetor të monitorimit të mjedisit, të miratuar nga ministri;

b) mbi bazën e të dhënave të monitorimit, Agjencia e Mjedisit dhe e Pyjeve harton raportin vjetor të gjendjes së mjedisit, të cilin ministri e paraqet për shqyrtim e miratim në Këshillin e Ministrave, ndërsa agjencitë rajonale hartojnë raportin e gjendjes së mjedisit në bazë qarku, të cilin e miraton këshilli i qarkut. Pas miratimit, këto raporte publikohen nëpërmjet mediave të shkruara dhe elektronike;

c) ndihmon grupet e kontrollit të Inspektoratit të Mjedisit me matje dhe analiza për shkarkimet në ajër, në ujë e në tokë, që gjenerojnë veprimtaritë që kontrollohen;

ç) ndihmon organet e pushtetit vendor për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit, që kanë në juridiksion, bashkëpunon për hartimin dhe zbatimin e planeve vendore të veprimit për mjedisin;

d) nxit përdorimin e teknologjive të pastra dhe futjen e sistemeve të administrimit mjedisor;

dh) merr pjesë në procesin e miratimit të lejes dhe të deklaratës mjedisore, duke përmbushur detyrat që përcakton ministri me udhëzim të veçantë. Në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore, jep pëlqimin dhe autorizimin mjedisor për veprimtari vendore, si forma të lejes mjedisore;

e) në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis për veprimtaritë, që do të ushtrohen në territorin që kanë në juridiksion, bashkëpunon me organet e qeverisjes vendore, informon publikun dhe siguron tërheqjen e tij në vendimmarrje;

ë) publikon të dhëna për mjedisin dhe plotëson kërkesat e publikut për informacionet mjedisore që ai u kërkon;

f) angazhohet në studime e projekte mjedisore, që drejton ministria apo organet e qeverisjes vendore.”.

Neni 20

Në nenin 70 bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

“1. Në përbërje të ministrisë funksionon Inspektorati i Mjedisit, si organ i specializuar kontrolli për mjedisin dhe për zbatimin e legjislacionit mjedisor.

2. Inspektorati i Mjedisit përbëhet nga Kryeinspektori, nga inspektorët në ministri dhe nga

njësitë e inspektoratit në qarqe. Me propozimin e ministrit, Këshilli i Ministrave miraton organizimin dhe funksionimin e njësive të inspektoratit për çdo qark.”.

2. Pikat 5 dhe 6 shfuqizohen.

Neni 21

Pas nenit 86 shtohet neni 86/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 86/1

Shpërblimi i dëmit

1. Për çdo rast të kryerjes së kundërvajtjes administrative apo të veprës penale në mjedis, vlerësohet edhe dëmi që i është shkaktuar mjedisit dhe kërkohet shpërblimi i tij nga personi përgjegjës.

2. Kriteret dhe mënyra e caktimit të vlerës së dëmit të shkaktuar në mjedis miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.”.

Neni 22

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shkronja “b” e nenit 20 të ligjit nr.9537, datë 18.5.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”, shfuqizohet.

Neni 23

Në nenin 88 bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 1, pas fjalëve “79 pika 3” shtohen fjalët “22 pikat 3 e 4, 51/1 pika 1, 70 pika 2, 86/1 pika 2”.

2. Në pikën 2, pas fjalëve “87 pika 2” shtohen fjalët “25/1 pika 4, 39/2, 45/1 pikat 1 e 3, 46 shkronja “e”, 51/1 pika 2 dhe 66 shkronja “d””.

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5679, datë 31.3.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.9891, datë 20.3.2008

**PËR RATIFIKIMIN E NDRYSHIMIT TË “MARRËVESHJES SË RISHITJES SË
AKSIONEVE TË INSIG SHA-SË NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCIVE, QË VEPRON
NË EMËR TË SHTETIT SHQIPTAR, KORPORATËS FINANCIARE NDËRKOMBËTARE
(IFC) DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM (BERZH)”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet ndryshimi i “Marrëveshjes së rishitjes së aksioneve të INSIG sha-së ndërmjet Ministrisë së Financave, që vepron në emër të shtetit shqiptar, Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.5676, datë 28.3.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

NDRYSHIMI I DYTË I MARRËVESHJES

SË RISHITJES SË AKSIONEVE NDËRMJET BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM DHE KORPORATËS FINANCIARE NDËRKOMBËTARE DHE MINISTRISË SË FINANCAVE, QË VEPRON NË EMËR TË SHTETIT SHQIPTAR

Datë 30 janar 2008

Ndryshimi i dytë i Marrëveshjes së Rishitjes së Aksioneve

Ndryshimi i dytë i Marrëveshjes së Rishitjes së Aksioneve (kjo “Marrëveshje e ndryshimit të dytë”), datë 30 janar 2008, ndërmjet Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Ministrisë së Financave, që vepron në emër të shtetit shqiptar, në pajtim me ligjin nr.8831, datë 22 nëntor 2001, mbi pronësinë shtetërore në shoqëritë tregtare financiare me kapital tërësisht shtetëror, pronar i aksioneve tek Instituti i Sigurimeve sh.a., përfaqësuar nga Ministri i Financave (MF).

Duke pasur parasysh që:

A) Më 28 tetor 2003, EBRD, IFC dhe MF (Palët) përfunduan një Marrëveshje të Blerjes së Aksioneve, (Marrëveshja e Blerjes së Aksioneve), sipas së cilës MF-ja i shiste EBRD-së aksionet e EBRD-së dhe MF-ja i shiste IFC-së aksionet e IFC-së; dhe

B) Sipas termave të Marrëveshjes së Blerjes së Aksioneve, më 28 tetor 2003, Palët përfunduan një Marrëveshje për Rishitjen e Aksioneve (Marrëveshja e Rishitjes së Aksioneve), që parashikon për EBRD-në dhe IFC-në për t’i rishitur aksionet e EBRD-së dhe IFC-së, MF-së, sipas termave dhe kushteve të caktuara në të; dhe

C) Më 10 gusht 2006, Palët e ndryshuan Marrëveshjen e Rishitjes së Aksioneve për të zgjatur periudhën e shitjes të përcaktuar në Marrëveshjen e Rishitjes së Aksioneve, me qëllim që t’i lejohet MF-së një periudhë më e gjatë në të cilën të identifikojë investitorin strategjik të pranueshëm për EBRD-në dhe IFC-në, dhe si pasojë e saj, të shtyjë ndodhinë e ngjarjes së daljes që do t’i lejonte EBRD-së dhe IFC-së të ushtronin të drejtat e tyre për t’i rishitur aksionet e EBRD-së dhe aksionet e IFC-së MF-së; dhe

D) Palët dëshirojnë për të ndryshuar përsëri Marrëveshjen e Rishitjes së Aksioneve për të zgjatur më tej periudhën e rishitjes.

Prandaj, Palët bien dakord si më poshtë:

Seksioni 1. Përkufizime. Të gjitha termat me germa kapitale të përdorura në këtë marrëveshje ndryshimi dhe që nuk përkufizohen ndryshe në të, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, kanë kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Rishitjes dhe Marrëveshjen e Blerjes së Aksioneve.

Seksioni 2. Ndryshim në Marrëveshjen e Rishitjes së Aksioneve:

Seksioni 2.1 Seksioni 1.1 (Interpretimi) i Marrëveshjes së Rishitjes ndryshohet në 10 gusht 2006, dhe ndryshohet më tej nëpërmjet ndryshimit të termit të përkufizuar më poshtë:

“Periudha e shitjes është periudha që fillon në datën e transferimit dhe që përfundon më 31 dhjetor 2008.

Seksioni 3. Hyrja në fuqi. Pas ratifikimit nga Parlamenti, kjo Marrëveshje e Ndryshimit të Dytë hyn në fuqi ditën e pesëmbëdhjetë pas botimit të ligjit përkatës që e miraton këtë Marrëveshje ndryshimi në Fletoren Zyrtare. Nëse kjo Marrëveshje nuk hyn në fuqi sipas dispozitave të këtij

seksioni 3, më 31 mars 2008, kjo Marrëveshje e Ndryshimit të Dytë konsiderohet e pavlefshme, përveç kur bihet dakord me shkrim ndërmjet të gjitha Palëve të saj.

Në dëshmi të kësaj, Palët kanë marrë masa për ta nënshkruar këtë Marrëveshje Ndryshimi të Dytë në emrat e tyre përkatës sipas datës së shkruar më sipër.

LIGJ

Nr.9892, datë 20.3.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9649, DATË 27.11.2006 “PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE TË FORMULËS SË PRIVATIZIMIT TË INSIG, SHA-SË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.9649, datë 27.11.2006 “Për përcaktimin e formës dhe të formulës së privatizimit të INSIG, sha-së”, pika 1 e nenit 3 ndryshohet si më poshtë:

“1. 61 për qind e aksioneve u ofrohen për shitje investitorëve strategjikë, të cilët përzgjidhen në bazë të procedurave të përcaktuara nga Ministria e Financave, me tender të hapur ndërkombëtar, brenda datës 31 dhjetor 2008.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5677, datë 28.3.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

VENDIM

Nr.174, datë 20.3.2008

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËR VEPRIMTARINË VJETORE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVISIONIT

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 7, pika 19 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet raporti i paraqitur nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit për veprimtarinë e tij gjatë vitit 2007.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)**

VENDIM
Nr.175, datë 27.3.2008

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
PËR SHKARKIM MINISTRI

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.5673, datë 21.3.2008 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.5673, datë 21.3.2008 për shkarkimin e zotit Fatmir Mediu nga detyra e Ministrit të Mbrojtjes.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.176, datë 27.3.2008

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
PËR SHKARKIM ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.5674, datë 21.3.2008 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.5674, datë 21.3.2008 për shkarkimin e zotit Gazmend Oketa nga detyra e Zëvendëskryeministrit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.177, datë 27.3.2008

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
PËR EMËRIM MINISTRI**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.5675, datë 21.3.2008 të Presidentit të Republikës,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.5675, datë 21.3.2008 për emërimin e zotit Gazmend Oketa në detyrën e Ministrit të Mbrojtjes.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM
Nr.9, datë 19.3.2008**

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datën 10.10.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dym të hapura çështjen nr.47/3 Akti, që i përket:

KËRKUES: KONFERENCA E REKTORËVE, me kryetar z.Shezai Rrokaj.

QENDRA “FORUMI I MENDIMIT TË LIRË”, TIRANË, me drejtor z.Mentor Kikija.

REKTORI I UNIVERSITETIT TË TIRANËS, z.Shezai Rrokaj.

REKTORI I UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS, z.Velesin Peçuli.

REKTORI I AKADEMISË SË ARTEVE, TIRANË, z.Kastriot Çaushti.

REKTORI I UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR XHUVANI" TË ELBASANIT,
z.Jani Dode.

REKTORI I UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" TË GJIROKASTRËS, z.Kristaq Kikina.

REKTORI I UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" TË VLORËS, z.Bilal Shkurtaj.

REKTORI I UNIVERSITETIT "LUIGJ GURAKUQI" TË SHKODRËS, z.Mahir Hoti.
REKTORI I UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS, z.Përparim Hoxha, të gjithë të përfaqësuar nga avokatët Artan Hajdari dhe Envi Hicka, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, i përfaqësuar nga z.Lulzim Lelçaj, me autorizim.

KËSHILLI I MINISTRAVE, i përfaqësuar nga z.Enkelejd Alibeaj, me autorizim.

OBJEKTI: 1. Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i fjalisë së tretë të pikës 1 të nenit 23 dhe pikave 2 dhe 3 të nenit 64 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë".

2. Pezullimi i zbatimit të dispozitave të ligjit, objekt i kësaj kërkesë, deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 18, 57, pika 7 dhe 131 shkronja "a" të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 45 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" dhe neni 3, pika 2, i ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë".

Kërkuesit, për shfuqizimin e dispozitave të ligjit të mësipërm, parashtruan se:

- Neni 23, fjalia e tretë, pika 1 e ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", që përcakton mënyrën e zgjedhjes së organeve dhe autoriteteve drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë, *cenon parimin e barazisë së shtetasve para ligjit dhe parimin e autonomisë universitare*, të parashikuar nga nenet 18 dhe 57, pika 7, të Kushtetutës. Ai prek edhe *parimin e barazisë së votës*, të parashikuar nga neni 45 i Kushtetutës, sepse i jep vlerë të ndryshme votave të dhëna për kandidatin që kërkon të mandatohet për herë të parë, në raport me kandidatin që kërkon të mandatohet për herë të dytë.

- Neni 64, pika 2, i ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 *cenon autonominë e institucioneve të arsimit të lartë*, të sanksionuar në nenin 57, pika 7, të Kushtetutës, sepse duke i njohur Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të drejtën për të shfuqizuar aktet e institucioneve të arsimit të lartë, u heq atyre mundësinë për t'u vetëqeverisur.

- Neni 64, pika 3, i ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 që parashikon të drejtën e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës për të pezulluar rektorët nga detyra, si dhe kalimin e kompetencave të rektorëve të zëvendësrektorët, është i papajtueshëm me nenin 92, shkronja "g" të Kushtetutës, sipas të cilit Presidenti ka në kompetencë të emërojë rektorët e universiteteve.

Subjektet e interesuara pretenduan se:

- Qendra "Forumi i Mendimit të Lirë", Konferenca e Rektorëve dhe rektorët nuk legjitimohen, në kuptim të nenit 134 të Kushtetutës, si subjekte që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.

- Neni 23 i ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" nuk prek nenin 45 të Kushtetutës, pasi kjo dispozitë kushtetuese rregullon çështjen e zgjedhjeve në kuadrin e organizimit shtetëror. E drejta për të kandiduar për postet e autoriteteve drejtuese të arsimit të lartë nuk është një e drejtë kushtetuese.

- Cenimi i barazisë së votës, i pretenduar prej kërkuesve, vjen ndesh me parimin e qarkullimit të elitave universitare dhe akademike, i cili sjell prosperitetin e institucioneve të arsimit të lartë.

- Neni 64, pikat 2 dhe 3, i ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 nuk prek autonominë e institucioneve të arsimit të lartë. Autonomia e këtyre institucioneve është domen i rregullimit ligjor. Ligji u njeh institucioneve të arsimit të lartë të drejtën që organizimin e brendshëm ta bëjnë vetë, duke përjashtuar mundësinë që rregullat apo normat e tjera të caktohen nga pushteti qendror.

- E drejta e Ministrit për të shfuqizuar aktet e institucioneve të arsimit të lartë është kontroll mbi ligjshmërinë dhe jo mbi dobishmërinë apo oportunitetin e këtyre akteve.

- Aktet e Ministrit, të nxjerra për shfuqizimin e akteve të institucioneve të arsimit të lartë, mund të goditen në rrugë gjyqësore.

- Akti i Ministrit për pezullimin e rektorit nga detyra, nuk prek të drejtën e Presidentit të Republikës për emërimin dhe shkarkimin e rektorit, parashikuar prej nenit 92, shkronja "g" të Kushtetutës.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes z.Gjergji Sauli, përfaqësuesit e kërkuësve dhe të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Në kërkesën e paraqitur për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese kërkohet shfuqizimi për papajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të fjalisë së tretë të pikës 1 të nenit 23 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, që ka këtë përmbajtje: “Autoriteti drejtues i një institucioni publik të arsimit të lartë, që konkurren në mandatin e dytë për të njëjtin funksion, duhet të sigurojë 60 për qind të numrit të vlefshëm të votave për t’u shpallur fitues.”.

Gjithashtu kërkohet shfuqizimi i pikave 2 dhe 3 të nenit 64 të ligjit të mësipërm, që kanë këtë përmbajtje: Pika 2: “Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka të drejtë të shfuqizojë çdo akt të nxjerrë nga autoritetet apo organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë kur këto akte vijnë në kundërshtim me këtë ligj.”; Pika 3: “Në raste flagrante ose shkelje të rënda të ligjit dhe akteve nënligjore nga rektori i një institucioni të arsimit të lartë, Ministri i Arsimit dhe Shkencës urdhëron pezullimin e tij, duke ia dërguar atë për procedura të mëtejshme Presidentit të Republikës, i cili duhet të përgjigjet brenda një muaji. Ministri i Arsimit dhe Shkencës cakton njërin prej zëvendësrektorëve që të zëvendësojë rektorin e pezulluar, deri në zgjedhjen e rektorit të ri, sipas këtij ligji. Ministri i Arsimit dhe Shkencës, menjëherë pas dekretimit të shkarkimit, shpall zgjedhje të parakohshme.”

Gjykata Kushtetuese, nisur nga pretendimet e paraqitura prej subjekteve të interesuara lidhur me legjitimitimin e kërkuësve, çmon të nevojshme që përpara se të marrë në shqyrtim objektin e kërkesës, të shprehet nëse kërkuësit bëjnë pjesë në rrethin e subjekteve që legjitimohen të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Rrethi i këtyre subjekteve përcaktohet në nenin 134 të Kushtetutës. Në pikën 1, shkronja “f”, të kësaj dispozite thuhet shprehimisht se Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të partive politike dhe organizatave të tjera, por kjo e drejtë u është dhënë e kufizuar, sepse sipas pikës 2 të po këtij neni të Kushtetutës, këto subjekte mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.

Problemi i legjitimitimit të subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, është vlerësuar prej saj si një element i rëndësishëm i inicimit të procesit kushtetues. Në gjykimet e kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, për të legjitimuar subjektet iniciuese, Gjykata Kushtetuese ka kërkuar paraprakisht që ato të provojnë nëse janë subjekte që parashikohen në nenin 134, pika 2, të Kushtetutës dhe nëse çështja kushtetuese e paraqitur për shqyrtim ka lidhje me interesat e tyre. Në plotësim të këtyre kërkesave, Gjykata Kushtetuese i ka konsideruar organizatat si subjekte që ushtrojnë të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për ato çështje që lidhen me interesat e tyre.¹

Konferenca e Rektorëve, sipas ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, është një organ kolegjal i pavarur i autoriteteve drejtuese të institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë, që kryen veprimtari në fushën e zhvillimit, koordinimit dhe të kërkitimit shkencor të arsimit të lartë. Ajo, duke pasur në thelb karakterin e një organizate me anëtarësi, gjatë veprimtarisë së saj, shpreh opinione për probleme të respektimit të autonomisë së institucioneve të arsimit të lartë, ose për çdo problem tjetër kur e gjykon të nevojshme, si dhe mban lidhje me shoqata homologe për nxitjen e shkëmbimeve universitare që ndihmojnë në përparimin e arsimit të lartë dhe kërkitimin shkencor. Nisur nga lidhja që ekziston ndërmjet objektit të veprimtarisë së Konferencës dhe çështjes së paraqitur për shqyrtim, Gjykata Kushtetuese konkludon se Konferenca e Rektorëve legjitimohet në paraqitjen e kërkesës së saj para Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 134, pika 1 shkronja “f”, dhe pikës 2 të Kushtetutës.

Qendra “Forumi i Mendimit të Lirë” është një organizatë jofitimprurëse, që ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit në fuqi. Objekti i veprimtarisë së kësaj organizate, i parashikuar në statut, është dhe nxitja e zhvillimit të legjislacionit në fushën e arsimit, mbrojtja e interesave të ndryshme të institucioneve arsimore të çdo niveli, respektimi i parimit të autonomisë universitare, si dhe promovimi i edukimit shoqëror e individual, bazuar në vlerat e demokracisë liberale.

Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se objekti i veprimtarisë së kësaj

¹ Vendim i GJK nr.36, datë 8.2.2007.

organizate jofitimprurëse lidhet me çështjet kushtetuese të ngritura prej saj në kërkesën për gjykim, çka e legjitimon edhe këtë subjekt për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e kërkesës.

Gjykata Kushtetuese vlerëson të drejtë pretendimin e subjekteve të interesuara lidhur me moslegjitimitimin e rektorëve të universiteteve për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes. Në bazë të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, rektori është autoritet drejtues i institucionit të arsimit të lartë dhe si i tillë, ai nuk përfshihet në radhën e subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese në bazë të nenit 134, pika 1, të Kushtetutës. Në këto kushte, rektori nuk ka të drejtë që t'i drejtohet kësaj Gjykate për çështje që kanë të bëjnë me gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës.

Kërkuesit pretenduan se neni 23, pika 1, fjalia, e tretë i ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, që përcakton mënyrën e zgjedhjes së organeve dhe autoriteteve drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë, cenon parimin e barazisë së shtetasve para ligjit dhe parimin e autonomisë universitare, të parashikuara në nenet 18 dhe 57 të Kushtetutës. Gjatë fazës së diskutimit të kësaj çështjeje, Gjykata Kushtetuese konstatoi se Kuvendi, me ligjin nr.9832, datë 12.11.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë””, ka ndryshuar plotësisht pikën 1 të nenit 23 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, ndryshim i cili ka hyrë në fuqi me kalimin e afatit 15-ditor të botimit në Fletoren Zyrtare.² E ndodhur para një fakti të tillë, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se nuk mund të shprehet për pretendimet e kërkuesve lidhur me papajtueshmërinë me Kushtetutën të fjalisë së tretë, pika 1, të nenit 23 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, pasi kjo dispozitë në momentin e vendimmarrjes nuk ekziston, sepse është ndryshuar tërësisht. Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese çmon se shqyrtimi i çështjes për pikën 1 të dispozitës së mësipërme, objekt i kërkesës, pushon dhe për pasojë, bashkë me të, bie automatikisht edhe vendimi i gjykatës për pezullimin e zbatimit të kësaj dispozite.

Kërkuesit kanë pretenduar se pika 2 e nenit 64 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, vjen në kundërshtim me parimin e autonomisë së institucioneve të arsimit të lartë, të sanksionuar në nenin 57, pika 7, të Kushtetutës. Në këtë dispozitë të Kushtetutës thuhet se: “Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë dhe liria akademike janë të garantuara me ligj.”.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se për zgjidhjen e çështjes se mësipërme, objekt gjykimi, brenda aspektit të kontrollit kushtetues të normës së ligjit, të merret paraprkishtë me kuptimin e parimit të autonomisë universitare. Ky parim, në vështrimin historik, filloi të formësohej kur u krijuan universitetet si entitete të shkencës dhe studimit dhe kur lindi nevoja e autonomisë së tyre, që synoi të siguronte pavarësinë e universiteteve nga shteti. Qëllimi i kësaj autonomie ishte ruajtja e lirisë së shkencës, kërkimit shkencor dhe mësimdhënies, si dhe mbrojtja e studiuesve dhe profesorëve nga influencat politike etj., nisur nga ideja se shkencat dhe mësimdhënia, normalisht, mund të ekzistojnë dhe të sjellin progres vetëm kur janë të lira dhe të pavarura.

Parimi i autonomisë universitare është i lidhur ngushtë dhe me parimin e lirisë akademike, i cili është shprehje e përpjekjeve për të mbrojtur, lirinë e mendimit shkencor të personave që merren me kërkime shkencore dhe me mësimdhënie. Autonomia universitare është një formë institucionale e lirisë akademike dhe një parakusht për të garantuar përmbushjen e duhur të funksioneve që u janë besuar personelit mësimdhënës dhe institucioneve të arsimit të lartë. Autonomia universitare është thelbi i vetëqeverisjes, e nevojshme për vendimmarrjen efektive të institucioneve të arsimit të lartë në përmbushjen e detyrave akademike dhe arsimore.

Parimi i autonomisë universitare kërkon nga universitetet që të jenë subjekte të përgjegjshme dhe transparente në marrjen e vendimeve të tyre dhe në shpenzimet e fondeve. Kjo realizohet nëpërmjet mbikëqyrjes së veprimtarisë së universiteteve, nga organizma të ngarkuar për këtë qëllim, por kjo mbikëqyrje duhet të kryhet pa cenuar parimin e autonomisë universitare.

Respektimi i parimit të autonomisë së institucioneve të arsimit të lartë, të sanksionuar në nenin 57, pika 7, të Kushtetutës, kërkon që ligji të krijojë dimensione të tilla, që institucionet e arsimit të lartë të pajisen me pushtet të mjaftueshëm për të marrë vendime në mënyrë të lirë e të pavarur. Vetëqeverisja, kolegjaliteti dhe drejtimi i përshtatshëm akademik janë elemente thelbësore të autonomisë së vërtetë për institucionet e arsimit të lartë.

Këto elemente gjejnë shprehje në pikën 2 të nenit 3 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për

² Fletorja Zyrtare nr.153, datë 16.11.2007.

arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”. Sipas kësaj dispozite, autonomia e institucioneve të arsimit të lartë shprehet në këto drejtime: në të drejtën e vetëqeverisjes së tyre në organizimin e strukturave të brendshme, në zhvillimin e veprimtarive nëpërmjet statuteve dhe rregulloreve të tyre; në të drejtën e zhvillimit të pavarur të veprimtarive kërkimore shkencore për hartimin e programeve studimore dhe projekteve të kërkimit; në të drejtën për të caktuar kritere të pranimit të studentëve; në të drejtën për të administruar fonde publike ose për të mbledhur dhe administruar fonde të tjera, si dhe për të realizuar marrëveshje me qeverinë ose me organizma të tjera për trajnime, kualifikime, ose për projekte kërkimore-shkencore.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se dispozita e mësipërme shpreh minimumin e garantimit kushtetues të autonomisë universitare. Ajo është veçanërisht e rëndësishme sepse përbën bazën e autonomisë universitare, e cila nuk mund të kufizohet nga ligji.

Autonomia universitare duhet të zhvillohet në mënyrë që të inkurajojë dhe ndihmojë në zhvillimin e arsimit dhe të shkencës. Elementet bazë të saj nuk mund të kufizohen. Për çështje të tjera kufizimet mund të vihen, por edhe ato duhet të jenë legjitime, domethënë në pajtim me standardet kushtetuese.

Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, sipas pikës 2 të nenit 64 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, i është dhënë e drejta që të shfuqizojë çdo akt të nxjerrë nga autoritetet apo organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë, kur këto akte vijnë në kundërshtim me këtë ligj. Gjykata Kushtetuese vë në dukje se nuk mund të ketë garantim të parimit të autonomisë së institucioneve të arsimit të lartë në rast se mbikëqyrja prej Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës ushtrohet në mënyrën e parashikuar nga dispozitat e mësipërme. Kjo për faktin se shfuqizimi i akteve që konsiderohen të paligjshme, drejtpërdrejt nga Ministri apo Ministria e Arsimit dhe Shkencës, siç është shprehur në ligj, i vendos universitetet nën kontrollin hierarkik të pushtetit ekzekutiv, sikur ato të ishin organe në vartësi të tij. Në këtë mënyrë ligji, nga garant për respektimin e parimit kushtetues të autonomisë së institucioneve të arsimit të lartë, kthehet në një instrument që e cenon atë nëpërmjet ndërhyrjes së organeve ekzekutive.

Meqenëse arsimi i lartë është një shërbim publik, me ligj mund t’u jepen organeve të pushtetit ekzekutiv kompetenca kontrolluese mbi universitetet, por këto kompetenca duhet të jenë të balancuara dhe proporcionale, në mënyrë që ushtrimi i tyre të mos cenojë autonominë e institucioneve të arsimit të lartë që është thelbi i vetëqeverisjes, si dhe të kontribuojnë në zhvillimin pozitiv të marrëdhënieve të ndërsjella. Për një problem të tillë, Gjykata Kushtetuese është shprehur se “ushtrimi i tagrës së vendimmarrjes përbën një shprehje të efektivitetit të autonomisë institucionale dhe ndërhyrja e shtetit, pikërisht në këtë aspekt thelbësor, do të sillte vështirësi në zbatimin e ligjit dhe do të cenonte standardet kushtetuese të kësaj autonomie, si dhe të lirisë akademike.”³

Nisur nga vlerësimet e mësipërme, Gjykata Kushtetuese çmon se pika 2 e nenit 64 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” duhet shfuqizuar, sepse cenon parimin e autonomisë universitare, të parashikuar në nenin 57, pika 7, të Kushtetutës.

Kërkesit kanë pretenduar gjithashtu papajtueshmërinë e pikës 3 të nenit 64 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, me nenin 57, pika 7, të Kushtetutës. Në këtë dispozitë të ligjit është parashikuar se, në raste flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit dhe akteve nënligjore nga rektori i një institucioni të arsimit të lartë, Ministri i Arsimit dhe Shkencës urdhëron pezullimin e tij dhe ia dërgon çështjen për procedura të mëtejshme Presidentit të Republikës, i cili duhet të përgjigjet brenda muajit. Është parashikuar gjithashtu që Ministri i Arsimit dhe Shkencës cakton njërin prej zëvendësrektorëve për të zëvendësuar rektorin e pezulluar, deri në zgjedhjen e rektorit të ri dhe, pas dekretimit të shkarkimit, shpall zgjedhje të parakohshme.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të kërkesës, për pikën 3 të nenit 64 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, Gjykata Kushtetuese nuk mundi të shprehet për pajtueshmërinë ose jo të dispozitës së mësipërme me Kushtetutën, pasi nuk u arrit shumica e kërkuar nga neni 72 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 74 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për

³ Vendim i GJK nr.36, datë 15.10.2007.

organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, do të refuzojë kërkesën për deklarimin si antikushtetues të pikës së tretë të nenit 64 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/a të Kushtetutës dhe nenit 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të pikës 2 të nenit 64 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”.

- Pushimin e shqyrtimit gjyqësor të kërkesës për pikën 1, fjalë e tretë, të nenit 23 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe heqjen e masës së pezullimit të zbatimit të nenit 23 të këtij ligji.

- Refuzimin e kërkesës për pikën 3 të nenit 64 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vladimir Kristo (kryetar), Fehmi Abdiu, Sokol Sadushi, Kujtim Puto, Gjergj Sauli, Sokol Berberi.

Anëtar kundër: Kristofor Peçi.

Anëtar pjesërisht kundër: Petrit Plloçi.

MENDIM PARALEL

Nuk jam dakord me arsyetimin e shumicës, sipas së cilës e drejta e Ministrit të Arsimit për të shfuqizuar aktet e nxjerra nga autoritetet apo organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë që vijnë në kundërshtim me këtë ligj, është në tërësinë e vet antikushtetuese. Ligjvënësi, në nenin 63 të ligjit të ri “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ka ngarkuar Ministrit të Arsimit përgjegjësinë për realizimin e programit qeverisës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, në funksion të garantimit të së drejtës kushtetuese të shtetasve për arsim, të parashikuar nga neni 57 i Kushtetutës, për të përmbushur njëkohësisht dhe një nga objektivat socialë të renditura në nenin 59 të Kushtetutës. Jo vetëm kaq, por në paragrafin e parë të nenit 64 të ligjit, Ministria e Arsimit ngarkohet me detyrën për të ushtruar kontroll, të paktën një herë në tre vjet, për zbatimin e ligjshmërisë në institucionet publike ose private të arsimit të lartë dhe të paktën një herë në vit kontroll financiar në institucionet publike të arsimit të lartë. Nga ana tjetër, ligjvënësi, nëpërmjet këtij ligji ka përmbushur detyrimin kushtetues të parashikuar në pikën 7 të nenit 57 të Kushtetutës, sipas të cilit: “Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë është e garantuar me ligj”. Ligji në tërësinë e tij synon të përmbushë këto detyrime kushtetuese, duke bërë njëkohësisht një harmonizim proporcional midis autonomisë së institucioneve arsimore nga njëra anë dhe interesit publik për të garantuar të drejtën e shtetasve për arsim nga ana tjetër. E drejta e shfuqizimit të akteve administrative të kundërligjshme është një e drejtë e natyrshme e organeve të administratës shtetërore, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tyre të ngarkuara me ligj. Ndonëse institucionet e arsimit të lartë nuk janë në varësi të drejtpërdrejtë të Ministrisë së Arsimit, për shkak dhe të autonomisë që ato gëzojnë (Vini re: është fjala për autonomi dhe jo pavarësi), kjo e fundit, duke pasur me ligj të drejtën e kontrollit të ligjshmërisë në këto institucione, në mënyrë mjaftueshmërisht të arsyetueshme, duhet të ketë dhe të drejtën e vënies në vend të ligjshmërisë, nëpërmjet shfuqizimit të akteve që ajo i konsideron të kundërligjshme. Por, kjo e drejtë duhet të jetë proporcionale dhe jo absolute, siç është formuluar në pikën 2 të nenit 64. Ministria, natyrisht nëpërmjet Ministrit, ka dhe duhet të ketë të drejtën e shfuqizimit vetëm të atyre akteve që nuk

prekin thelbin e autonomisë së institucioneve arsimore dhe lirinë e tyre akademike. Nisur dhe nga përmbajtja e nenit 3 të ligjit, i cili sanksionon parimet bazë të autonomisë së institucioneve të arsimit të lartë dhe lirinë e tyre akademike, është detyrë e shtetit të respektojë dhe garantojë këto parime. Në këtë kuptim, edhe e drejta e Ministrit për të shfuqizuar këto akte që lidhen me to nuk mund të jetë e pakufizuar. Pikërisht këtu qëndron dhe antikushtetutshmëria e pikës 2 të nenit 64 të ligjit, formulimi i të cilit i jep të drejtë Ministrit që të shfuqizojë edhe akte që lidhen me çështje të tilla si vetëqeverisja e institucioneve të arsimit të lartë; e drejta për hartimin e pavarur të programeve të studimit; e drejta për të caktuar kriteret e pranimit në programet e studimit; e drejta për të mbledhur fonde dhe liria e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe krijimit; të cilat parashikohen në pikat 2 dhe 3 të nenit 3 të ligjit “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”. Jashtë këtyre përcaktimeve, Ministrit të Arsimit, mund dhe duhet t’i njihet e drejta të shfuqizojë çdo akt tjetër të institucioneve arsimore që bie ndesh me këtë ligj. Edhe në këto raste, pavarësisht se ligji nuk shprehet, nisur nga parimet e përgjithshme të së drejtës e në veçanti nga pika 2 e nenit 42 të Kushtetutës, institucionet e arsimit të lartë ruajnë të drejtën që t’i drejtohen gjykatës kur çmojnë se vendimi i Ministrit për shfuqizim është i paligjshëm apo prek autonominë e tyre ose lirinë akademike.

Kryetar: Vladimir Kristo.

VENDIM Nr.10, datë 19.3.2008

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergji Sauli	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datë 5.11.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.48/4 Akti, që i përket:

KËRKUES: SHOQATA “LIDHJA E BIZNESMENËVE TË LOJËRAVE ELEKTRONIKE”, përfaqësuar nga av. Shefqet Muçi, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I SHQIPËRISË, përfaqësuar nga z.Lulzim Lelçaj, me autorizim.

2. KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga z.Enkelejd Alibeaj, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 2, pika 3, të ligjit nr.9744, datë 28.5.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, i ndryshuar.

Shoqata “Lidhja e biznesmenëve të lojërave elektronike” ka paraqitur para Gjykatës Kushtetuese një kërkesë, me anë të së cilës pretendon se neni 2, pika e 3, e ligjit nr.9744, datë 28.5.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, i ndryshuar, i cili jep një përkufizim të ri të lojërave elektronike me fitim në çast duke përcaktuar si të tilla vetëm makinat elektronike të tipit “slot”, është antikushtetues dhe si i tillë duhet të shfuqizohet.

Kërkuesi paraqet këto argumente lidhur me antikushtetutshmërinë e dispozitës objekt shqyrtimi:

- Ndryshimi që sjell ligji i ri është cenim i lirisë së veprimtarisë ekonomike, e sanksionuar nga

neni 11 i Kushtetutës, pasi ndalon ushtrimin e kësaj veprimtarie për këto lloj makinerish në mënyrë të pajustificuar. Kufizimi në këtë rast është bërë në mungesë të një interesi publik, i cili, sipas kërkesit, është i vështirë të evidentohet.

- Dispozita e re ka sjellë kufizimin e së drejtës së pronës për kërkesin, pasi duke përjashtuar nga ushtrimi i veprimtarisë makineritë me më shumë se një pozicion loje, ai është i detyruar t'i nxjerrë ato jashtë përdorimit, gjë e cila, sipas tij, sjell kosto të konsiderueshme për subjektet e këtij aktiviteti. Një veprim i tillë, sipas kërkesit, barazohet me shpronësimin, i cili në këtë rast është bërë pa u respektuar nga ligjvënësi kriteret kushtetuese, si shpërblimi i drejtë dhe interesi publik.

- Liria e veprimtarisë ekonomike dhe e drejta e pronës janë cenuar pa një proces të rregullt ligjor, pasi ligjvënësi nuk ka marrë më parë mendimin e subjekteve që preken nga ky rregullim duke mosrespektuar të drejtën për t'u dëgjuar.

- Parashikimi i dispozitës objekt shqyrtimi bie ndesh me parimin e sigurisë juridike dhe të të drejtave të fituara, pasi prish një marrëdhënie të rregulluar më parë me ligj dhe licencën e fituar sipas kriterëve përkatëse për këtë qëllim.

- Lejimi i përdorimit të makinerive me shumë pozicione loje vetëm nga kazinotë krijon situatë monopoli, pasi në Shqipëri ekziston vetëm një kazino.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Kuvendit të Shqipërisë, është shprehur se pretendimet e kërkesit janë të pabazuara, duke parashtruar se:

- Liria e veprimtarisë ekonomike nënkupton ushtrimin e saj sipas formave dhe kriterëve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

- Interesi publik në parashikimin e këtij kufizimi lidhet me parandalimin e efekteve negative që mbart në vetvete loja me këto makineri nga moshat e reja ose grupet e personave vulnerabël, kontrollimi më i mirë i kësaj veprimtarie nga ana e shtetit, mbrojtja e konsumatorit etj.

- Kufizimi i ushtrimit të veprimtarisë për makinat e tipit "slot" nuk krijon monopol, pasi, pavarësisht se aktualisht ka vetëm një kazino, ligji u jep mundësinë të gjitha subjekteve të interesuara në marrjen e licencës ta ushtrojnë këtë të drejtë nëse plotësojnë kushtet e vendosura për këtë qëllim.

- Dispozita e ndryshuar nuk sjell zhveshjen nga e drejta e pronësisë të kërkesit. Ai mund të vazhdojë t'i disponojë makineritë njëlloj si më parë. Ajo që kufizohet është përdorimi i këtyre sendeve për qëllime fitimi në një lloj të caktuar aktiviteti.

- Ndryshimi i ligjit është bërë duke respektuar parimin e procesit të rregullt ligjor, pasi janë zbatuar të gjitha kriteret e parashikuara për këtë qëllim gjatë procesit ligjvënës.

Përfaqësuesi i Këshillit të Ministrave kundërshtoi pretendimet e kërkesit me këto argumente:

- Ndryshimi i ligjit nuk synon mohimin ose mosushtrimin e veprimtarisë ekonomike konkrete për kërkesin. Ai thjesht ka për qëllim rregullimin dhe disiplinimin e kësaj veprimtarie duke vendosur kriterë ligjore të caktuara. Çdo subjekt që i plotëson këto kriterë ka të drejtë të ushtrojë veprimtarinë e tij në këtë fushë.

- Arsyet për ekzistencën e interesit publik të këtij rregullimi ligjor gjenden në vetë përmbajtjen e relacionit që shoqëron projektligjin nga ana e Këshillit të Ministrave. Ato janë: ndalimi i nxitjes së pjesëmarrjes në të personave vulnerabël, ndalimi i publicitetit, forcimi i rregullave të licencimit, rregullimi i kategorizimit të lojërave elektronike, rritja e të ardhurave të buxhetit të shtetit etj.

- Kërkesit nuk i kufizohet e drejta e pronësisë, pasi makineritë janë dhe mbeten në posedim dhe disponim të drejtpërdrejtë të pronarëve të tyre. Pretendimi se makineritë e tyre nuk mund të përdoren më tej nuk është argument për shpronësimin e tyre.

- Kufizimi i lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe i të drejtës së pronës është bërë në respektim të parimit për një proces të rregullt ligjor, pasi operatorët që veprojnë në këtë fushë kanë të drejtë të ankohen administrativisht dhe gjyqësisht nëse u shkelen të drejtat e tyre. Pretendimi për mosrespektimin e procesit të rregullt ligjor duhet të lidhet me një situatë faktike ligjore, dhe jo me shqyrtimin e një akti normativ vetëm atëherë pasi individit të ketë ezauruar të gjitha mjetet ligjore në dispozicion.

- Pretendimi se është cenuar parimi i sigurisë juridike është i pabazuar, pasi ndryshimi ligjor nuk i heq licencën e marrë këtyre subjekteve për ushtrimin e aktivitetit. Ligji në vetvete nuk saktëson

shprehimisht llojin konkret të lojërave që lejohen të zhvillohen, kështu që ndryshimi i bërë nuk revokon një të drejtë të njohur më parë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, z.Xhezair Zaganjori, përfaqësuesin e kërkuarit, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kuvendi i Shqipërisë, me ligjin nr.9744, datë 28.5.2007 “Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, ka bërë disa ndryshime, me anë të të cilave, midis të tjerave, është bërë edhe ripërkufizimi i konceptit të lojërave elektronike me fitim në çast. Për këtë qëllim, neni 2 i këtij ligji parashikon se: “Nuk konsiderohen lojëra elektronike me fitim në çast makinat elektronike apo kompjuterët elektronikë, të cilët kanë më shumë se një pozicion loje. Lojërat elektronike me fitim në çast, sipas këtij ligji, konsiderohen vetëm makinat e tipit “slot”. Personat, të cilët kanë instaluar makina elektronike apo kompjutera elektronikë, të cilët nuk konsiderohen si të tillë nga paragrafi i mësipërm, detyrohen t’i heqin ato brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.”

Kërkuari pretendon se ky ndryshim i ligjit e ka cenuar në të drejtën e tij për të ushtruar lirisht veprimtarinë ekonomike si dhe në të drejtën e pronës, për shkak se, sipas tij, ai nuk mund t’i shesë apo tjetërsojë makinat që, në bazë të këtij ligji, nuk mund t’i përdorë më. Këto të drejta, sipas kërkuarit, janë shkelur pa respektuar një proces të rregullt ligjor, si dhe parimin e sigurisë juridike.

1. Pretendimi i parë i kërkuarit është se moslejimi i ushtrimit të veprimtarisë edhe për makinat me më shumë se një pozicion loje nga subjektet e përcaktuara në ligj sjell kufizim të pajustifikuar të lirisë ekonomike të garantuar nga neni 11 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Gjykata Kushtetuese e çmon të nevojshme që para se t’i japë përgjigje pretendimeve të kërkuarit, të ndalet në konceptin e lirisë së veprimtarisë ekonomike të garantuar nga neni 11 i Kushtetutës. Kjo dispozitë parashikon: “Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike. Prona private dhe publike mbrohen njëjloj me ligj. Kufizimet e lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike.”

Liria e veprimtarisë ekonomike është një prej koncepteve më të reja që ka zënë vend në kushtetutat moderne. Kjo liri nënkupton kryesisht të drejtën për të lidhur kontrata, individualisht ose kolektivisht, lirisht dhe mbi bazën e vullnetit personal, të drejtën për të zgjedhur aktivitetin që dëshiron të ushtrojë individi, të drejtën për të pasur një punë sipas preferencës, etj. Një individ i lirë ekonomikisht është ai që mund të kontrollojë plotësisht punën ose pronën e tij.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se liria e veprimtarisë ekonomike lidhet drejtpërdrejt edhe me hapësirën që i lihet individit për të vepruar me qëllim zhvillimin e lirë të personalitetit të tij aty, ku ai e sheh veten më produktiv. Kjo liri përfshin të gjitha të drejtat që lidhen me prodhimin, shpërndarjen ose konsumin e mallrave dhe të shërbimeve. Forma më e lartë e lirisë ekonomike nënkupton të drejtën e pronës, lirinë e qarkullimit të punës, të kapitalit dhe të mallrave pa asnjë kufizim. Në këtë kuptim, individi ka të drejtë të punojë, të prodhojë, të konsumojë dhe të investojë në çdo mënyrë që i pëlqen dhe kjo liri duhet të mbrohet nga shteti.

Liria e veprimtarisë ekonomike përmban në vetvete shumë të drejta dhe liri, si: liria e biznesit ose aftësia për të krijuar dhe mbyllur një sipërmarrje, liria e tregtisë ose mungesa e barrierave lidhur me importimin dhe eksportimin e mallrave dhe shërbimeve, liria monetare si masë për të garantuar qëndrueshmëri të çmimit, liria fiskale mbi të ardhurat qoftë individuale, qoftë ndaj biznesit në mënyrë të veçantë, të drejtat e pronës si aftësi e individëve për të grumbulluar, poseduar dhe disponuar sende të lirë nga ndërhyrja e shtetit, liria e investimit dhe qarkullimit të lirë të kapitaleve, veçanërisht kapitalit të huaj, liria financiare dhe pavarësia nga kontrolli shtetëror, liria e punës për të ndërvepruar pa kufizime nga shteti.

E parë në këtë këndvështrim, Gjykata Kushtetuese nënvizon se liria e veprimtarisë ekonomike është një liri negative për aq kohë sa lidhet me vullnetin e individit për të zgjedhur fushën e ushtrimit të kësaj veprimtarie duke hyrë lirisht në marrëdhënie ekonomike me subjekte të tjera. Përveç kësaj, liria e veprimtarisë ekonomike ka dhe aspektin e saj pozitiv. Ai përmban detyrimin e shtetit që,

nëpërmjet ligjvënësist, të ndërhyjë në rregullimin e kësaj lirie, me qëllim që krahas lirisë së veprimtarisë ekonomike të garantohet edhe parimi i shtetit social dhe i të mirës së përbashkët. Ky detyrim për rregullim i ligjvënësist shprehet nëpërmjet nxjerrjes së normave konkrete juridike, me anë të të cilave synohet disiplinimi i ushtrimit të veprimtarisë së lirë ekonomike në sektorë apo fusha të caktuara. Në këtë rast, shteti duhet të luajë rolin e katalizatorit për realizimin efektiv të lirisë ekonomike nga njëra anë dhe mbrojtjes së kësaj lirie nga ana tjetër. Vetëm shteti mund të arrijë të krijojë mjedisin e vërtetë dhe optimal për ushtrimin e kësaj lirie vetjake, prandaj ai duhet parë si rregullator me qëllim mbrojtjen e tregut nga deformimet që natyrshëm mund t'i mbartë me vete zhvillimi i lirë i veprimtarisë ekonomike⁴.

Nisur nga roli aktiv i shtetit, hartuesi i Kushtetutës ka parashikuar kriteret mbi bazën e të cilave ai mund të ndërhyjë për të rregulluar ushtrimin e kësaj të drejte. Konkretisht, neni 11/3 i Kushtetutës, ku bazohet edhe kërkuesi në pretendimet e tij, parashikon se kufizimet e lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se kemi të bëjmë me kritere që lidhen drejtpërdrejt me një liri konkrete, siç është ajo e veprimtarisë ekonomike. Nisur dhe nga struktura e Kushtetutës, e veçanta e kësaj dispozite është se ajo nuk është parashikuar në grupin e të drejtave dhe lirive të tjera, por në pjesën ku parashikohen parimet themelore mbi të cilat mbështetet organizimi dhe funksionimi shtetëror i vendit. Pra, hartuesi i Kushtetutës ka preferuar ta konsiderojë lirinë e veprimtarisë ekonomike së pari, si parim bazë të sistemit ekonomik të Republikës së Shqipërisë dhe së dyti, si pjesë e katalogut të lirive dhe të drejtave të shtetasve. Është pikërisht ky element dallues i kësaj lirie, pra qenia e saj si një nga shtyllat e shtetit demokratik, që i jep kësaj lirie një natyrë të veçantë. Kjo veçanti shprehet edhe në aspektin e parashikimit të kriterit kufizues në të njëjtën dispozitë që duhet të aplikohet në raste konkrete. Pavarësisht këtij kriteri kufizimi, duke qenë se Gjykata Kushtetuese po shqyrton cenimin ose jo të kësaj lirie të lidhur ngushtë me sferën e individit, është e detyruar t'i drejtohet edhe përmbajtjes së nenit 17/1 të Kushtetutës, e cila shtrihet ndaj të gjitha të drejtave dhe lirive të parashikuara në të. Konkretisht, dispozita e nenit 17/1 parashikon: “kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.” Pra, kjo dispozitë, përveç arsyes publike, të cilën e gjejmë edhe tek neni 11/3, përmban detyrimin për të respektuar edhe kritere të tjera, si: kufizimi me anë të ligjit dhe ekzistenca e raportit të drejtë midis kufizimit dhe gjendjes që e dikton atë. Parimi i njohur i proporcionalitetit nënkupton që ndërhyrja e ligjvënësist për kufizimin e një të drejte të caktuar të bëhet me mjete të përshtatshme që i përgjigjen drejt qëllimit që synohet të arrihet.

Gjykata Kushtetuese e sheh me vend që të shprehet fillimisht lidhur me ekzistencën ose jo të një kufizimi në këtë rast nga ana e ligjvënësist me qëllim që të arrijë në përfundimin nëse ky kufizim ka sjellë apo jo me vete edhe cenim të lirisë së veprimtarisë ekonomike, siç pretendon kërkuesi.

Me anë të dispozitës objekt shqyrtimi është ndryshuar përkufizimi i termit “makina elektronike” duke përjashtuar si të tilla makinat me shumë pozicione loje. Subjektet, të cilat posedojnë këto lloj makinash, sipas dispozitës së ndryshuar, nuk duhet t'i përdorin më ato, në rast se nuk përmbushin kriteret e përcaktuara për këtë qëllim. Pra, ligjvënësi, me anë të këtij ndryshimi, ka parashikuar kritere shtesë me qëllim përdorimin e një tipi të caktuar makine elektronike nga subjektet e licencuara për ushtrimin e këtij aktiviteti. Ky fakt, në vetvete, mund të barazohet me një kufizim, pasi tashmë për subjektet konkrete ndryshon situata aktuale, duke ngushtuar ushtrimin e veprimtarisë lidhur me këtë lloj makine, për shkak të kriterëve të reja të vendosura nga dispozita objekt shqyrtimi.

Gjykata Kushtetuese çmon se, për rastin konkret, shtimi i kriterëve nga ana e ligjvënësist me qëllim ushtrimin e një veprimtarie të caktuar, është brenda hapësirës së tij të veprimit dhe vlerësimit. Është e drejtë e ligjvënësist të vlerësojë rast pas rasti nevojën e ndërhyrjes me anë të një rregullimi të ri. Nevoja e një bashkëjetese të qetë midis anëtarëve të shoqërisë si dhe objektivave me interes të përgjithshëm, nuk do të thotë detyrimisht që të drejtat themelore të garantohen pa asnjë kufizim⁵. Detyra e Gjykatës Kushtetuese, kur ushtron kontroll ndaj ndërhyrjeve të ligjvënësist në rregullime që

⁴ Shih praktikën e Gjykatës Europiane të Drejtësisë në Luksemburg: çështja 8/74 *Procureur du Roi kundër Dassonville* (1974) ECR 837 ; çështja *Saeger kundër Dennemeyer* (1991) ECR I-4221.

⁵ Vendimi i Gjykatës Europiane të Drejtësisë në Luksemburg i 4 korrik 2000, çështja *Haim*, C-424/97, Rec p.I-5123.

prekin të drejtat dhe liritë themelore, është vlerësimi nëse ky kufizim është bërë sipas kritereve të përcaktuara shprehimisht në Kushtetutë, pra me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

Duke iu referuar kushteve të nenit 17/1 në lidhje dhe me nenin 11/3 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese e çmon të nevojshme të ndalet kryesisht në analizën e dy kritereve kryesore: parimit të interesit publik dhe parimit të proporcionalitetit të ndërhyrjes legislative, të cilat, si rregull, bashkërendohen dhe plotësohen nga njëri-tjetri.

Koncepti kushtetues i interesit publik, ashtu siç është trajtuar tashmë në disa raste nga kjo Gjykatë, është mjaft i gjerë dhe duhet parë në këndvështrimin e dispozitës konkrete që paraqitet për kontroll para saj⁶. Është e vështirë të radhiten në mënyrë shteruese rastet e interesit publik ose të arsyes publike që të çojnë në kufizimin e një të drejte themelore. Ato mund të renditen vetëm negativisht, pra në aspektin e kufizimit konkret. Në praktikën kushtetuese është pranuar tashmë se ligjvënësi, parimisht, është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë⁷.

Në respektim të interesit publik, pranohen si kufizime të arsyeshme të lirisë së veprimtarisë ekonomike iniciativat e ligjvënësit, të cilat shërbejnë për një rregullim të tregut apo interesave të një shteti social⁸. Këto masa të ligjvënësit mund të jenë të shumëllojshme, madje edhe të karakterit monetar, si p.sh. vendosja e tatimeve dhe taksave, e cila konsiderohet në vetvete si një lloj kufizimi⁹. Është konsideruar në përgjithësi i mjaftueshëm garantimi i mundësisë së individit për të zgjedhur lirisht fushën e veprimtarisë së tij (iniciativa ekonomike) dhe për të realizuar idetë e tij mbi aktivitetin ekonomik që ai ka zgjedhur. Ajo që ka rëndësi në këtë rast është që thelbi i këtij aktiviteti të individit të mos cenohet deri në atë masë sa të bëhet i pamundur ushtrimi i tij¹⁰.

Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese çmon se interesi publik që e ka çuar ligjvënësin drejt amendimit të ligjit objekt shqyrtimi ka qenë i tillë që e justifikon ndërhyrjen e tij. Rritja e garancisë për të marrë pjesë në lojërat e fatit nëpërmjet rritjes së kontrollit ndaj subjekteve që ushtrojnë këtë aktivitet, forcimi i rregullave të licencimit dhe përmirësimi i shpërndarjes gjeografike të subjekteve, rritja e të ardhurave në buxhetin e shtetit nëpërmjet rritjes së detyrimeve tatimore, kategorizimi dhe ndarja e lojërave të fatit, mbrojtja më e mirë e të rinjve, etj., konsiderohen nga Gjykata Kushtetuese si arsye të rëndësishme publike që përlligjin rregullimin e ri. Të gjitha këto interesa ligjvënësi i ka parë të arsyeshme t'i garantojë nëpërmjet shtimit të kritereve për marrjen e licencës për këtë qëllim. Ligjvënësi e ka lënë rrugën të hapur për secilin subjekt që përmbush kriteret e vendosura për ushtrimin e aktivitetit edhe për makinat me shumë pozicione loje.

Nisur nga ky fakt, Gjykata Kushtetuese çmon se vetëm shtimi i kritereve për ushtrimin e një veprimtarie të caktuar, pa u shoqëruar me masa përjashtuese ose diskriminuese karshi subjekteve të tjera, nuk mund të konsiderohet si antikushtetues për sa kohë që aktiviteti nuk cenohet në thelbin e tij ose bëhet i pamundur për t'u ushtruar. Të gjitha subjektet që do të duan të marrin një licencë për ushtrimin e aktivitetit edhe për makineritë me shumë pozicione loje, janë të lira ta bëjnë këtë pasi të kenë plotësuar kushtet për marrjen e licencës. Vetëm pamundësia për të plotësuar kriteret e subjekteve nuk mund të konsiderohet cenim i veprimtarisë ekonomike. Nuk është në përgjegjësinë dhe detyrimin e shtetit t'u bëjë të mundur nga pikëpamja financiare subjekteve ushtrimin e një aktiviteti të caktuar. Detyrimi i shtetit është të hartojë kuadrin e nevojshëm ligjor për këtë qëllim duke u krijuar mundësinë të gjithëve të konkurrojnë në një treg të lirë.

Gjykata çmon se ligjvënësi ka respektuar parimin e vendosjes së raportit të drejtë midis interesit publik dhe garantimit e mbrojtjes së lirisë së individit, duke forcuar kriteret e licencimit me qëllim rritjen e garancisë dhe mbrojtjes së konsumatorëve, të grupeve vulnerabël, si dhe shtimin e të ardhurave në buxhetin e shtetit. Në të njëjtën kohë, ligjvënësi u ka dhënë subjekteve tregtare mundësinë e ushtrimit të mëtejshëm të aktivitetit të tyre në rast të plotësimit të kritereve prej tyre.

Lidhur me kriterin e dytë të kufizimeve të të drejtave dhe lirive themelore, pra

⁶ Vendime të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë: V-16/2004; V-35/2007.

⁷ Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Federale Gjermane: BVerfGE 76,1.

⁸ Vendimi i Gjykatës Europiane të Drejtësisë në Luksemburg i 21 shtator 1999, *Laara dhe të tjerë* C-124/97, Rec.p.I-6067.

⁹ Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Federale Gjermane: BVerfGE 29, 260.

¹⁰ Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Federale Gjermane: BVerfGE 4, 7 (16); 8, 274.

proporcionalitetit të ndërhyrjes legislative, Gjykata Kushtetuese vlerëson se rregullimi i ligjvënësimit është në përpjesëtim të drejtë me qëllimin që e ka diktuar një veprim të tillë. Siç u tha më lart, qëllimi që kërkon të arrijë ligjvënësi me anë të rregullimit të ri është disiplinimi i ushtrimit të një veprimtarie ekonomike, konkretisht i lojërave të fatit. Në një situatë të pastabilizuar ende, edhe për shkak se kjo veprimtari është relativisht e re në vendin tonë, shteti është i detyruar që të bëjë të gjitha përpjekjet e duhura me qëllim kontrollimin dhe ndalimin e përhapjes së varësisë ndaj bixhozit të shtresave më të prirura ndaj këtij fenomeni. Shteti, duke vendosur kritere më të forta për licencimin e subjekteve, ka mundësi të ndalojë përhapjen e pakontrolluar dhe të padisiplinuar të kësaj veprimtarie duke mbrojtur konsumatorët. Në këtë kuptim, nisur nga faktorë ekonomikë dhe socialë, ligjvënësi ka gjetur shtimin e kriterëve të licencimit si mjet të përshtatshëm për realizimin e rolit rregullues të shtetit.

2. Sa i përket edhe pretendimit tjetër të kërkuarit se dispozita objekt shqyrtimi cenon të drejtën e pronës, pasi detyrimi për heqjen e makinerive me shumë pozicione i sjell atij kosto të konsiderueshme, Gjykata Kushtetuese çmon se ai nuk është i bazuar. Koncepti i të drejtës së pronës është mjaft i gjerë dhe shtrihet si ndaj sendeve të paluajtshme, ashtu dhe ndaj atyre të luajtshme. Ky koncept mbulon edhe një hapësirë të madhe interesash ekonomikë. Në kuptim edhe të nenit 1 të protokollit shtesë nr.1 të KEDNJ-së, si elemente përbërëse të së drejtës së pronësisë janë, veç të tjerash, interesa materiale dhe jomateriale, si patenta, aksione, e drejta për pension, e drejta për të dhënë me qira, e drejta për të ushtruar një profesion etj. Vetë dispozita e nenit 1 të protokollit shtesë nr.1 të KEDNJ-së përmban tri rregulla mbi bazë të të cilave bëhet kontrolli nëse kemi të bëjmë me cenim të së drejtës së pronës në kundërshtim me këtë dispozitë. Kështu, rregulli i parë lidhet me gëzimin e lirë të pronës në paqe; rregulli i dytë lidhet me kufizimin e së drejtës së pronësisë sipas kushteve të caktuara dhe rregulli i tretë u njeh shteteve të drejtën për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm, duke vënë në zbatim ligje që i gjykojnë të nevojshme për këtë qëllim. Të tri këto rregulla i përgjigjen të njëjtit qëllim: garantimin e pronarit nga ndërhyrje të tilla të shtetit që mund të arrijnë deri në atë pikë sa të rrezikojnë ekzistencën e veprimtarisë fitimprurëse që ai ushtron¹¹.

Në këtë kuptim, Gjykata Kushtetuese vlerëson se dispozita ligjore objekt shqyrtimi ka për qëllim rregullimin e një situate konkrete lidhur me një aktivitet të caktuar. Konkretisht, për të pasur makineritë me disa pozicione loje duhet që të plotësohen disa kritere të parashikuara në ligj. Ky është edhe qëllimi përfundimtar i kësaj dispozite. Kjo dispozitë nuk synon në asnjë pjesë të saj, si direkt ashtu dhe indirekt, shpronësimin e subjekteve lidhur me makineritë konkrete. Nxjerrja jashtë përdorimit e makinerive mund të vijë për shkaqe të ndryshme. Për sa kohë që aktiviteti i subjekteve të licencuara më parë për posedimin e makinerive me disa pozicione, do të lejohet vetëm në rast se plotësohen disa kritere të vendosura me ligj, atëherë subjekti është i lirë t'i mbajë ato. Mundësia e shitjes, dhënies me qira apo tjetërsimi i tyre me forma të tjera të përcaktuara me ligj, është një e drejtë ekskluzive e kërkuarit. Me qëllim realizimin sa më mirë të kësaj të drejte ligjvënësi ka parashikuar edhe klauzolën që brenda një afati 6-mujor subjektet të kenë mundësi t'i shfrytëzojnë dhe t'i disponojnë lirisht makineritë e tyre, me qëllim mosardhjen e pasojave të menjëhershme ndaj atyre që nuk i plotësojnë më kriteret për të ushtruar aktivitetin me makineritë me shumë pozicione loje.

Në asnjë pjesë të dispozitave ndryshuese subjekteve, të cilët janë pronarë apo posedues të këtyre makinerive, nuk u mohohet ushtrimi i gëzimit dhe disponimit të makinerive me anë të këtij rregullimi, as *de facto* as *de jure*. Nëse ligji do të ndalonte nxjerrjen në treg të këtyre makinerive, atëherë mund të gjykonim mbi kriteret ku mbështetet ligjvënësi për këtë qëllim. Për këto arsye, Gjykata Kushtetuese vlerëson se nuk ndodhet para cenimit të së drejtës së pronës në kuptim të nenit 41 të Kushtetutës.

3. Një pretendim tjetër i kërkuarit lidhur me antikushtetutshmërinë e dispozitës objekt shqyrtimi është dhe mosrespektimi nga ligjvënësi i parimit të sigurisë juridike, pasi është ndryshuar një situatë e rregulluar më parë duke u hequr të drejtën subjekteve të ushtrojnë veprimtarinë për një lloj makine të caktuar.

Siguria juridike, si koncept kushtetues i trajtuar disa herë nga praktika e deritanishme e Gjykatës Kushtetuese, përfshin qartësinë, kuptueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit normativ¹².

¹¹ Vendime të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg: *James kundër Mbretërisë së Bashkuar* A98 (1996); *Sporrong dhe Lannorth kundër Suedisë* A52 (1982).

¹² Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë: V-26/2005, V-34/2005.

Ky parim përfshin, midis të tjerave, edhe besimin tek sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situatë të favorshme ligjore¹³. Kështu, edhe fillimi i efekteve faktike si pasojë e ndryshimit të një ligji nuk mund të konsiderohen si cenim i parimit të sigurisë juridike. Në këtë pikëpamje, duhet parë në çdo rast se në çfarë mase dhe deri ku besimi që ka qytetari në situatën e favorshme ligjore paraqitet i rëndësishëm për t'u mbrojtur dhe cilat janë arsyet për një mbrojtje të tillë¹⁴.

Gjykata Kushtetuese rithekson se parimi i sigurisë juridike bashkëvepron edhe me parime të tjera, si ai i shtetit social, i cili i siguron ligjvënësit një hapësirë të gjerë dhe të papërcaktueshme saktësisht për të rregulluar përfitimin e të mirave sociale në një masë dhe sasi të caktuar. Është detyrim i shtetit krijimi i mundësive për një jetesë dinjitoze të qytetarëve. Në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese vlerëson se jo çdo masë me efekte negative që merr ligjvënësi për subjektet e ligjit është cenim i një të drejte të garantuar me Kushtetutë. Ligjvënësi jo vetëm që ka të drejtë, por është i detyruar të rregullojë nëpërmjet akteve të veta me hollësi të drejtat e parashikuara në Kushtetutë. Vetëm ato të drejta, të cilat janë parashikuar si shprehimisht të pakufizueshme nuk është e mundur të preken nga ligjvënësi.

Në vijim të arsytimit të mësipërm, nuk rezulton të provohet nga kërkuesi se përse kufizimi i licencës vetëm për një lloj makinerie i sjell atij dëme shumë të mëdha ose të tilla që do të rrezikonin ushtrimin e mëtejshëm të aktivitetit ekonomik apo do ta cenonin atë në thelbin e tij duke i sjellë pasoja të pariparueshme subjekteve që preken nga ky ligj. Pretendimi se ligji ka efekt prapaveprues duhet parë i lidhur ngushtë edhe me dispozitat e tjera të tij. Konkretisht, neni 20 i ligjit ndryshues parashikon edhe efektet e dispozitave për atë veprimtari që nuk do të ushtrohet më nga subjektet. Kështu, ligji përcakton se për licencat që janë lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që duhet të revokohen po sipas këtij ligji, shteti ka detyrimin t'u kthejë subjekteve shumat që rrjedhin nga revokimi. Përveç kësaj, ligji në asnjë prej dispozitave të tij nuk synon heqjen tërësisht të licencës së dhënë, ai e kufizon atë vetëm për një lloj makinerie, konkretisht të asaj me shumë pozicione loje. Pjesa tjetër e licencës, pra ajo që është dhënë për llojet e tjera të makinerive dhe kompjuterëve, do të vazhdojë të jetë e vlefshme për subjektet e këtij ligji edhe në të ardhmen.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se thjesht fakti i ardhjes së pasojave edhe për subjektet që e kanë marrë licencën para daljes së këtij ligji nuk është argument në favor të antikushtetutshmërisë së tij. E drejta e ligjvënësit për të rregulluar një situatë ndryshe nga ajo ekzistuese duhet të mbetet në thelb e paprekur, si një nga kërkesat e një shoqërie në zhvillim të vazhdueshëm, e cila nuk mund të kuptohet pa një kuadër normativ dinamik që i përshtatet zhvillimit të saj. Ajo që ka rëndësi është lloji dhe masa e dëmit që i vjen kërkuesit nga një rregullim i tillë. Lidhur me këtë pikë, kërkuesi nuk arriti të provojë realisht dëmin apo pasojën negative që i shkaktohet atij nga efektet e ligjit.

4. Gjykata Kushtetuese e quan të pabazuar gjithashtu edhe pretendimin se vendosja e kriterëve shtesë për ushtrimin e këtij aktiviteti krijon situatë monopoli, për shkak se në Shqipëri vepron aktualisht vetëm një subjekt me cilësinë e kazinosë. Një nga karakteristikat e veprimtarisë së lirë ekonomike është edhe dinamizmi i saj, që nënkupton ndryshimin e vazhdueshëm të një situatë të caktuar tregu. Ligji parashikon edhe shpërndarjen gjeografike të kazinove, duke u dhënë mundësinë të gjitha subjekteve të kërkojnë licencën për këtë qëllim. Pra, fakti se sot ka vetëm një kazino nuk do të thotë se kjo situatë diktohet nga ligji, ajo përcaktohet nga tregu në Shqipëri, gjë e cila mund të ndryshojë me kalimin e kohës.

5. Gjykata Kushtetuese e gjen të pabazuar në fakte edhe pretendimin e kërkuesit lidhur me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, garantuar nga neni 131/f i Kushtetutës, pasi për ndryshimin e ligjit nuk është marrë parasysh mendimi i grupeve të interesit, konkretisht i subjektit kërkues, duke i mohuar të drejtën për t'u dëgjuar.

Gjykata Kushtetuese thekson se koncepti i procesit të rregullt ligjor shtrihet edhe në veprimtarinë ligjvënëse dhe ka të bëjë konkretisht me respektimin e procedurave konkrete të hartimit dhe miratimit të ligjit. Gjatë seancës gjyqësore, si dhe nga dokumentacioni përkatës që pasqyron

¹³ Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Federale Gjermane: BVerfGE 63, 215, 223.

¹⁴ Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Federale Gjermane: BVerfGE 105, 17, 37.

procesin ligjvënës lidhur me miratimin e ligjit objekt kërkesë, nuk u arrit të provohej nga kërkuesi asnjë mangësi që të mund ta bënte këtë proces të parregullt nga pikëpamja kushtetuese. Gjykata Kushtetuese vlerëson se ligjvënësi, gjatë miratimit të ligjit objekt shqyrtimi, ka respektuar të gjitha procedurat konkrete të parashikuara nga Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit për miratimin e ligjeve.

Si përfundim, në vijim të arsyetimit të mësipërm, Gjykata Kushtetuese konstaton se përmbajtja e dispozitës së nenit 2, pika 3 të ligjit nr.9744, datë 28.5.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, i ndryshuar, është në përputhje me nenet 11/3, 17/2, 41/4 dhe 42/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 145/2 të Kushtetutës dhe të nenit 68 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vladimir Kristo (kryetar), Fehmi Abdiu, Xhezair Zaganjori, Sokol Sadushi, Petrit Plloçi.

Anëtarë kundër: Gjergj Sauli, Kristofor Peçi, Sokol Berberi, Kujtim Puto.

MENDIM I PAKICËS

Nuk jemi dakord me mendimin e shumicës.

Neni 11 i Kushtetutës përcakton ndër të tjera se: “Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike”. Ai përcakton gjithashtu se: “Kufizime të lirisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike”.

Ky nen shpalos vlerat kushtetuese mbi të cilat është bazuar ekonomia kombëtare. Këto vlera janë prona private e publike, ekonomia e tregut dhe liria e individit për t’u angazhuar në veprimtari ekonomike.

Kuptimi i lirisë së veprimtarisë ekonomike individuale është shumë i gjerë. Ndër të tjera ai përfshin të drejtën e individit për të zgjedhur dhe ushtruar lirisht llojin e biznesit, lirinë për të lidhur kontrata, konkurrencën e ndershme, barazinë e të drejtave të subjekteve gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, lirinë për të prodhuar, tregtuar dhe konsumuar të mira materiale dhe shërbime pa përdorur dhunë, mashtrime apo vjedhje. Por, kjo liri kërkon konkurrencën e ndershme dhe barazinë e të drejtave të subjekteve gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike. Liria e veprimtarisë ekonomike nënkupton në vetvete një kompleks të tërë mundësish, të cilat krijojnë parakushtet që një person (qoftë ky fizik, apo juridik), të marrë në mënyrë të pavarur vendimet e nevojshme në lidhje me aktivitetin e tij. Liria e

veprimtarisë ekonomike, duke u parashikuar si një parim themelor kushtetues, shoqërohet me detyrimin e legjislatorit për të mos nxjerrë ligje që krijojnë kushte të papërshtatshme, ose që njëkohësisht e kufizojnë atë jashtë kriterëve të parashikuara në Kushtetutë.

Liria e veprimtarisë ekonomike bazohet thelbësisht në lirinë e individit për të poseduar, gëzuar dhe disponuar pronën. Kur kufizohet liria e individit për të pasur dhe gëzuar pronën e tij, atëherë edhe liria e veprimtarisë së tij ekonomike është gjithashtu e kufizuar.

Një nga parakushtet kryesore për respektimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike është ekzistenca e shtetit të së drejtës. Nëse kriteret e shtetit të së drejtës nuk reflektohen në marrëdhënien shtet-individ, atëherë mund të nxirren ligje arbitrare ose të paqarta, që cenojnë lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe sigurinë ligjore. Natyrisht, kërkesa për siguri ligjore nuk do të thotë se legjislacioni duhet të mbetet gjithmonë i pandryshuar, por ajo kërkon që këto ndryshime të synojnë të sjellin si rregull pasoja pozitive, konkretisht mbrojtjen sa të jetë e mundur më shumë të veprimtarisë ekonomike.

Por, liria e individit për të ushtruar një veprimtari ekonomike, ashtu si dhe e drejta e pronës nuk janë të pakufizuara. Ato mund të kufizohen në kushte e neneve 11/3 dhe 17 të Kushtetutës, dispozita këto të marra në harmoni me njëra-tjetrën.

Sipas nenit 17 të Kushtetutës, është e lejueshme të kufizohen liritë dhe të drejtat individuale, por kjo duhet të bëhet me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe kufizimi të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të drejtave dhe, në asnjë rast, nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Duke krahasuar këto dispozita duhet thënë se neni 17 i Kushtetutës është *lex generalis*, ndërsa si *lex specialis* në këtë rast shërben rregullimi i dhënë nga neni 11, paragrafi 3, i Kushtetutës, i cili kërkon që kufizimi i lirisë së veprimtarisë ekonomike të vendoset vetëm për “arsye të rëndësishme publike”, duke u shndërruar kështu në një barrikadë ndaj kufizimeve të lirisë së veprimtarisë ekonomike që mund të bëhen thjesht për një interes publik, term ky jashtëzakonisht i gjerë, me të cilin mund të abuzohet.

Në rastin në gjykim, kërkuesi pretendon se ndryshimi që prezanton neni 2 i ligjit nr.9744, datë 28.5.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, jep një përkufizim të ri të “lojërave të fatit”, që ndryshon nga përkufizimi që ekzistonte përpara hyrjes në fuqi të ligjit të ri. Kjo ka sjellë si pasojë cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike, sepse sipas përkufizimit të ri “nuk konsiderohen lojëra elektronike me fitim në çast makinat elektronike apo kompjuterët elektronikë, të cilët kanë më shumë se një pozicion loje” (paragrafi i parë i pikës 3 të nenit të sipërpërmendur).

Ky ndryshim, i cili sipas paragrafit të dytë të dispozitës së mësipërme pasohet dhe me detyrimin e heqjes së makinave elektronike me më shumë se një pozicion loje brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përbën një kufizim të aplikuar gjatë ecurisë së veprimtarisë ekonomike të subjekteve, të cilët e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në bazë të lejeve të dhëna nga organet kompetente. Ky kufizim sjell automatikisht reduktimin drastik të të ardhurave që këto subjekte përfitonin nga biznesi i tyre.

Gjykata Kushtetuese, gjatë kontrollit abstrakt të normës së ankimuar, duhet të identifikonte nëse kriteret e përcaktuara nga nenet 11 (paragrafi 3) dhe 17 të Kushtetutës janë respektuar apo jo nga legjislatori, për të dhënë më pas vendimin nëse ky kufizim i lirisë së veprimtarisë ekonomike ishte konform Kushtetutës.

Sipas përfaqësuesit të Kuvendit dhe të Këshillit të Ministrave, në seancën gjyqësore, ndryshimet e realizuara nga ligji nr.9744, datë 28.5.2007 kishin për qëllim *ndalimin e efekteve negative që mbart në vetvete loja me këto makineri, si: pjesëmarrja në to e moshave të reja ose i grupeve të personave vulnerabël dhe mbrojtja e konsumatorit, forcimi i rregullave të licencimit dhe rritjen e të ardhurave të buxhetit të shtetit, etj...* Siç del, qëllimi që kërkon të arrijë ligjvënësi me anë të rregullimit të ri është disiplinimi i ushtrimit të një veprimtarie ekonomike thjesht për një interes publik. Veç kësaj, sipas nenit 17 të Kushtetutës, shkalla e kufizimit të së drejtës duhet të jetë në raport me qëllimin që kërkohet të arrihet, pra ky kufizim që sjell rregulli i ri, duhet të jetë jo vetëm i domosdoshëm, d.m.th. për arsye të rëndësishme publike, por dhe mënyra më e përshtatshme për të arritur këtë qëllim. Por, duke ballafaquar qëllimet e ndryshimeve me rregullimet ligjore rezulton se tek ligji ekzistues nr.8701 (që është dhe ligji bazë), në nenin 3, paragrafi 1, i titulluar “Mbrojtja e të

miturve”, është rritur mosha e personave që futen dhe luajnë në mjediset e lojërave të fatit, kazinove dhe hipodromeve nga 18 në 21 vjeç. Pra është kufizuar pjesëmarrja e të rinjve. Paragrafi i tretë i këtij neni vendos rregulla lidhur me *ndalimin e nxitjes së lojërave të fatit*, ndërsa paragrafi 4 vendos rregulla lidhur me *ndalimin e publicitetit të këtyre lojërave*. Po kështu, për kufizimin e efekteve negative, neni 4, pika 3/b *bën kufizimin e numrit të mjeteve në një sallë lodrash elektronike*. Neni 15 siguron disiplinimin e ushtrimit të veprimtarisë së lojërave të fatit dhe vendos edhe sanksionet administrative përkatëse, ndërsa neni 16 *vendos sanksione në lidhje me mosrespektimin e detyrimeve tatimore*. Pra, nga sa më sipër del qartë se rregullimi i ri nuk është i domosdoshëm dhe nuk është bërë për arsye të rëndësishme publike.

Legjislatori, nëse dëshironte të vinte kufizime të mëtejshme, mund të kishte gjetur dhe aplikuar mënyra të tjera jo kaq drastike, si p.sh. mund të ndalonte dhënien e licencave të reja, etj. Ndalimi i plotë i përdorimit të makinave me më shumë se një pozicion për subjektet e licencuara me “leje ushtrimi veprimtarie për lojëra fati”, ndërkohë që ato i lejohen kazinosë, bën edhe më të qartë që kjo ndërhyrje nuk është në përpjesëtim me qëllimin që synohet të arrihet dhe me pasojat e shkaktuara.

Shumica, në vendimin e saj, pajtohet me argumentin e paraqitur nga përfaqësuesit e Kuvendit dhe të Këshillit të Ministrave se nuk preket thelbi i së drejtës së kërkuesve përderisa ata kanë të drejtë të aplikojnë dhe të marrin licencën e kazinosë, pra kanë mundësi sërish të përdorin makineritë elektronike me më shumë se një pozicion. Me këtë arsyetim duket se nuk merret fare në konsideratë se veprimtaria e kazinosë është një lloj tjetër biznesi që ka kriteret dhe kushte të tjera që mund të jenë të paarrtshme nga kërkuesit. Por, edhe sikur kriteret për marrjen e kësaj licence të ishin të arritshme, problemi është që subjektet kërkuese, nga pikëpamja kushtetuese, janë të lira të zgjedhin llojin e biznesit, prandaj ato nuk mund të detyrohen që të ngrejnë veprimtarinë e tyre në nivel kazinoje. Kjo përballje në kriteret mes subjekteve kërkuese dhe kazinosë nuk del askund në dispozitat e ligjit nr.9744, datë 28.5.2007 që kundërshtohen, prandaj është pa lidhje të drejtpërdrejtë me çështjen. Kërkuesit, duke qenë të licencuar, kanë përdorur pa asnjë pengesë makinat me më shumë se një pozicion, deri përpara ripërkufizimit që u bëri “lojërave elektronike” ligji i sipërcituar. Në këto kushte, e drejta e tyre mund të kufizohet veçse pas mbarimit të afatit të licencës, por jo të ndërpritej menjëherë, sepse kjo dëmtoi thelbin e të drejtës së tyre për të ushtruar të lirë veprimtarinë ekonomike.

Kërkuesi pretendon, me të drejtë, se ndryshimi në legjislacion ka bërë që një numër prej 120 makinash elektronike me më shumë se një pozicion, me një vlerë të konsiderueshme (sipas dokumentacionit të paraqitur në seancë një prej tyre kushton jo më pak se 70.000 euro), të dalë jashtë përdorimit. Me ligjin e ri shteti ka realizuar një shpronësim *de facto* të tyre, sepse ato makineri, ndonëse do të jenë në posedim të pronarëve, do të mbeten të papërdorshme.

Meqenëse ligji e ndalon përdorimin e këtyre makinerive në vend, mundësia e shitjes apo dhënies së tyre me qira është objektivisht e pamundur, situatë kjo lehtësisht e parashikueshme, që duhej ta kishte shqetësuar legjislatorin, sepse bëhet fjalë për subjekte biznesi që kanë bërë investime të rëndësishme për biznesin e tyre dhe që paguajnë detyrimet financiare për shtetin shqiptar.

Neni 1 i protokollit 1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (tashmë pjesë e legjislacionit tonë të brendshëm) parashikon se “kushdo ka të drejtë të gëzojë në paqe zotërimet e tij” ku me “gëzim”, që hershëm, është kuptuar jo thjesht posedimi i sendit, por dhe marrja e fryteve që rrjedhin nga përdorimi i tij, sipas funksionit përkatës.

Natyrisht, nuk është në rolin dhe kompetencën e Gjykatës Kushtetuese të përcaktojë shumën ekzakte të dëmit, por ama, që nga momenti që bëhet i qartë se ky dëm është i pranishëm, është detyrë e kësaj Gjykate të shprehet për ekzistencën e tij dhe të arsyetojë mbi zgjidhjen e çështjes duke e marrë këtë dëm në konsideratë. Shumica zgjodhi të veprojë ndryshe.

Neni 41 i Kushtetutës përcakton se e drejta e pronës private është e garantuar. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës, por vetëm për interesa publikë dhe se shpronësimet ose kufizimet e të drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin lejohen vetëm përkundrajt një shpërblimi të drejtë.

Shumica, duke pranuar që ndryshimi i ligjit të kundërshtuar për antikushtetueshmëri nuk u sjell dëme të mëdha kërkuesve, i referohet nenit 20 të ligjit të ndryshuar. Ky referim është i gabuar. Neni i lartpërmendur nuk parashikon kthimin në favor të subjekteve kërkuese të shumave që rrjedhin nga ndërprerja e veprimtarisë së makinave me më shumë se një pozicion. Këto shuma u kthehen vetëm

subjekteve të lojërave “lotari çasti” dhe “lotari me shorte” që u revokohet licenca, pra jo për lojërat elektronike me fitim në çast, që është lloji i aktivitetit që kryejnë subjektet kërkuese.

Në këtë mënyrë, duke mos u parashikuar për subjektet kërkuese asnjë lloj dëmshpërblimi për ndërprerjen e menjëhershme të veprimtarisë së makinerive që luajnë rol kryesor në biznesin e tyre, gjykojmë se në fakt gjendemi para një *kufizimi në ushtrimin e së drejtës së pronës që barazohet me shpronësimin* (pra gjendemi para një shpronësimi *de facto*). Kushtetuta jonë, në këtë rast, interesin publik e kërkon vetëm për të justifikuar ndërhyrjen në të drejtën e pronës, ndërkohë që e lejon këtë ndërhyrje vetëm kundrejt një shpërblimi të drejtë. Duke mos u realizuar një shpërblim i tillë, janë shkelur konkretisht rregullimet e nenit 41 të Kushtetutës, sipas të cilave shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.

Është pretenduar nga ana e kërkuesit dhe shkelja e parimit të sigurisë juridike. Nga analiza e gjithë legjislacionit mbi fushën e lojërave të fatit del qartë se, ndonëse lejet për ushtrimin e veprimtarisë së lojërave të fatit nuk bëjnë fjalë posaçërisht për përdorimin nga subjektet kërkuese të “makinave elektronike me më shumë se një pozicion”, ligji (bazë) nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, i ndryshuar me ligjin nr.9459, datë 21.12.2005, i përmend ato me emër kur përcakton detyrimet tatimore për çdo pozicion loje. Këto makina kanë qenë në përdorim të vazhdueshëm nga ana e këtyre subjekteve dhe me “lojëra elektronike” janë kuptuar gjithmonë makinat me një dhe me më shumë se një pozicion (përndryshe ndryshimi i sjellë nga neni 2, paragrafi 3, i ligjit nr.9744 nuk do të kishte kuptim). Si rrjedhojë, çdo dhënie “Leje ushtrimi veprimtarie për lojëra fati” ka kuptuar dhe përdorimin e këtyre makinave me më shumë se një pozicion. Pikërisht, në bazë të kësaj situatë, sa faktike aq dhe ligjore, që ka vijuar për një kohë relativisht të gjatë, ushtruesit e këtyre veprimtarive kanë bërë dhe planbizneset e tyre (marrjen e kredive bankare për blerjet, investimet, marrjet me qira të ambienteve, përshtatjen e tyre në lidhje me funksionin, etj.). Dhënia e lejes ka krijuar besimin se nuk do të ketë ndryshime të këtij karakteri drastik, gjë që ka çuar në blerjen e makinave me vlerë të madhe dhe me më shumë se një pozicion, e që aktualisht, në mënyrë fare të paparashikueshme kanë dalë jashtë përdorimit.

Lirisë së veprimtarisë ekonomike, si çdo lirie e të drejte themelore, mund t’i bëhen kufizime me ligj e për arsye të rëndësishme publike, por, si rregull, kur kjo veprimtari nuk ka filluar, ose dhe kur ka filluar, por pasojat juridike të saj nuk janë ezauruar.

Në rastin e çështjes në shqyrtim gjykojmë se është cenuar parimi i sigurisë juridike dhe i pritshmërive të ligjshme. Kërkuesit, në mënyrë të arsyeshme, kishin sigurinë që legjislacioni nuk do të ndryshonte në mënyrë të tillë, të paktën deri në përfundim të afatit kohor të lejeve të ushtrimit të veprimtarisë së tyre, leje këto të dhëna nga institucionet shtetërore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Shteti vërtet mund të ndryshojë rregullimet ligjore të stabilizuara më parë duke e përkeqësuar gjendjen e këtyre subjekteve, por gjykojmë se kjo duhet të ndodhë vetëm nëse vërtetohet një situatë e posaçme në vend që e dikton atë ndryshim (neni 17 i Kushtetutës) dhe kur ndryshimi i legjislacionit në fjalë do të shërbejë për mbrojtjen e “interesave të rëndësishme publike” (neni 11, paragrafi 3, i Kushtetutës).

Asnjë prej këtyre parakushteve nuk u evidentua gjatë këtij gjykimi, prandaj kërkesa duhej të pranohej dhe të vendosej shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 2, pika 3, të ligjit nr.9744, datë 28.5.2007.

Anëtarë: Gjergj Sauli, Kristofor Peçi, Kujtim Puto.

VENDIM **Nr.12, datë 28.1.2008**

PËR MIRATIMIN E KOHËZGJATJES PËR FATURIMIN AFORFE PËR ABONENTËT FAMILJARË PA MATËS TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 9, nenit 51 dhe nenit 52 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në

mbledhjen e tij të datës 28.1.2008, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OSSH sh.a. për kohëzgjatjen e faturimit aforfe të energjisë elektrike në abonentët familjarë pa aparat matjeje të energjisë elektrike,

Niveli i aforfesë në verë

Niveli i aforfesë në

VENDOSI:

1. Kohëzgjatja për faturim aforfe për abonentët familjarë të energjisë elektrike pa matës të jetë deri në 31.12.2008.
2. Sasia e enegjisë elektrike e faturimit aforfe për klientët familjarë pa matës të energjisë elektrike (ndarë sipas rretheve) deri më 31.12.2008, do të jetë sipas tabelës bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Ngarkohet OSSH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

SASIA E ENERGJISË SË FATURUAR AFORFE PËR PERIUDHËN
1 JANAR DERI 31 DHJETOR 2008

Nr.	Emërtimi	Qytet	Fshat
1.	Tiranë qytet	400	
2.	Tiranë fshat		290
3.	Durrës	400	290
4.	Kavajë	400	230
5.	Krujë	390	290
6.	Shijak	0	290
7.	Fier	390	340
8.	Patos	390	220
9.	Ballsh	390	220
10.	Vlorë	350	220
11.	Bilisht	0	0
12.	Kolonjë	0	0
13.	Korçë	340	220
14.	Pogradec	0	0
15.	Gramsh	0	0
16.	Librazhd	0	0
17.	Peqin	0	0
18.	Elbasan	0	0
19.	Berat	390	220
20.	Kuçovë	0	220
21.	Lushnjë	390	290
22.	Skrapar	0	0
23.	Has	290	220
24.	Kukës	400	220
25.	Lezhë	390	280
26.	Koplik	390	280
27.	Pukë	0	0
28.	Tropojë	400	220
29.	Shkodër	400	250
30.	Bulqizë	0	220
31.	Dibër	0	220
32.	Laç	290	250
33.	Mat	0	220
34.	Mirditë	0	0
35.	Gjirokastër	0	220
36.	Përmet	0	0
37.	Sarandë	0	0
38.	Tepelenë	0	0
39.	Delvinë	0	0

Nr.	Emërtimi	Qytet	Fshat
1.	Tiranë qytet	600	
2.	Tiranë fshat		400
3.	Durrës	500	400
4.	Kavajë	550	400
5.	Krujë	450	350
6.	Shijak	0	400
7.	Fier	500	350
8.	Patos	450	300
9.	Ballsh	450	300
10.	Vlorë	500	300
11.	Bilisht	0	0
12.	Kolonjë	0	0
13.	Korçë	500	300
14.	Pogradec	0	0
15.	Gramsh	0	0
16.	Librazhd	0	0
17.	Peqin	0	0
18.	Elbasan	0	0
19.	Berat	500	350
20.	Kuçovë	0	300
21.	Lushnjë	450	350
22.	Skrapar	0	0
23.	Has	450	300
24.	Kukës	550	300
25.	Lezhë	550	350
26.	Koplik	400	300
27.	Pukë	0	0
28.	Tropojë	450	300
29.	Shkodër	500	300
30.	Bulqizë	0	250
31.	Dibër	0	250
32.	Laç	450	300
33.	Mat	0	300
34.	Mirditë	0	0
35.	Gjirokastër	0	300
36.	Përmet	0	0
37.	Sarandë	0	0
38.	Tepelenë	0	0
39.	Delvinë	0	0

Shënim: Periudha e verës: 1 prill-30 shtator.
 Periudha e dimrit: 1 janar-31 mars dhe 1 tetor-31 dhjetor

VENDIM
Nr.33, datë 21.3.2008

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË
 HERA SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES (PARKU EOLIK**

“PROJEKTI KAPPET”) SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s” neni 18, dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, neni 8, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 21.3.2008, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HERA” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues (Parku eolik “Projekti Kappet”), si burim i rinovueshëm energjie,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “HERA” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues (Parku eolik “Projekti KAPPET”), si burim i rinovueshëm energjie.
2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.34, datë 21.3.2008

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 54 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 “Rregullat e praktikave dhe procedurave të ERE-s”, neni 18 dhe neni 26, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.3.2008, pasi shqyrtoi dhe analizoi propozimin e grupit të punës për hartimin e draftit të rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të përgatisë të gjithë procesin ligjor për publikimin dhe njoftimin e vendimit të marrë.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.35, datë 21.3.2008

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË TARIFAVE PËR KOMPANINË PUBLIKE TË GJENERIMIT, METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË TARIFAVE PËR FURNIZUESIN PUBLIK ME SHUMICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE, METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË TARIFAVE TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË TARIFAVE PËR FURNIZUESIN PUBLIK ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë

elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.44, datë 24.7.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, neni 18, pika 1 germa “g”, dhe neni 26, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 21.3.2008, pasi u njoh me draftet e metodologjive të paraqitura,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të miratimit të metodologjisë së llogaritjes së tarifave për kompaninë publike të gjenerimit, metodologjisë së llogaritjes së tarifave për furnizuesin publik me shumicë të energjisë elektrike, metodologjisë së llogaritjes së tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe metodologjisë së llogaritjes së tarifave për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Çmimeve dhe e Tarifave, si dhe Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për ndjekjen e procedurave ligjore për miratimin e këtyre akteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.36, datë 21.3.2008

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES TIP MES
FURNIZUESIT PUBLIK ME SHUMICË DHE FURNIZUESIT PUBLIK ME PAKICË**

Në mbështetje të neni 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 “Rregullat e praktikave dhe procedurave të ERE-s”, neni 18 dhe neni 26, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.3.2008, pasi shqyrtoi dhe analizoi propozimin e grupit të punës për hartimin e draftit të marrëveshjes tip mes furnizuesit publik me shumicë dhe furnizuesit publik me pakicë,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e marrëveshjes tip mes furnizuesit publik me shumicë dhe furnizuesit publik me pakicë.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të përgatisë të gjithë procesin ligjor për publikimin dhe njoftimin e vendimit të marrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.37, datë 21.3.2008

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RISHIKIMIN E RREGULLORES SË
PROCEDURAVE TË LICENCIMIT**

Në mbështetje të neni 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, pika 1 germa “g”, dhe 26, të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.44 datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.3.2008, pasi u njoh me propozimin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi nevojën për një shtesë në rregullat e procedurave të licencimit lidhur me afatet e licencimit për veprimtaritë e eksportit dhe importit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për rishikimin e rregullores për procedurat e licencimit.
 2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për hartimin e ndryshimeve në rregullore.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.38, datë 21.3.2008

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.46, DATË 10.8.2007 “PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS SË GJOBAVE DHE LLOGARITJES SË DËMIT QË DO TË APLIKOHEN NDAJ KLIENTËVE ME KUNDËRVAJTJE NË PËRDORIMIN E ENERGISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, neni 18, pika 1 germa “f”, të kësaj rregulloreje, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.3.2008,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për një shtesë në vendimin nr.46, datë 10.8.2007 “Për përcaktimin e vlerës së gjobave dhe llogaritjes së dëmit që do të aplikohen ndaj klientëve me kundërvajtje në përdorimin e energjisë elektrike”.
 2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve për ndjekjen e procedurave.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.39, datë 21.3.2008

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E LICENCËS SË FURNIZIMIT PUBLIK ME SHUMICË TË ENERGISË ELEKTRIKE, LICENCËS SË SHPËRNDARJES SË ENERGISË ELEKTRIKE DHE LICENCËS SË FURNIZIMIT PUBLIK ME PAKICË TË ENERGISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9, 13 dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.44, datë 24.7.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s” neni 18, pika 1, germa “g”, dhe neni 26, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 21.3.2008, pasi u njoh me draftet e paraqitura, të licencës së furnizimit publik me shumicë të energjisë elektrike, licencës së shpërndarjes së energjisë elektrike dhe licencës së furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e licencës së furnizimit publik me shumicë të energjisë elektrike, licencës së shpërndarjes së energjisë elektrike dhe licencës së furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, si dhe Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për ndjekjen e procedurave ligjore për miratimin e këtyre akteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.40, datë 24.3.2008

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“HEC I TERVIOLIT” SHPK PËR LICENCIMIN NË AKTIVITETIN E NDËRTIMIT,
INSTALIMIT DHE PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 9, nenit 13, pika 1, germa “a”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s” neni 18, dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007 “Për miratimin e rregullores për procedurat e licencimit”, neni 10, pika 1, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 24.3.2008, pasi shqyrtoi aplikimin për licencimin në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe prodhimit të energjisë elektrike paraqitur nga shoqëria “HECI I TERVIOLIT” sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “HEC i Tervolit” sh.p.k., për ndërtimin, instalimin dhe prodhimin e energjisë elektrike (HEC i Tervolit).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin për procedurat që do të ndiqen në vijim të kërkesave të rregullores për procedurat e licencimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

KËRKESË

Nr.2207/1, datë 24.3.2008

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor Fier-Ballsh-Tepelenë (Povla 2).

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Republika e Shqipërisë
MPPTT
Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve
Drejtoria e Shpronësimeve

Lista e pronarëve që shpronësohet nga rehabilitimi i rrugës Fier-Ballsh-Tepelenë (nr.1-6)

Nr	Pronari								
	Emër	Mbiemër	Nr.pasurive	Sip/shpronësimi are,pemë m ²	Çmimi në lekë/m ²	Vlera në lekë	Vlera e kulturës bujqësore	Vlera e kult dru- frutor	Totali
1	Nuredin	Mukaj	124/9	1066	542	577772	10980		588752
2	Hysen	Mukaj	124/20	1617	542	876414	16979		893393
3	Hysen	Xhaferi	124/25	222	542	120324	2220		122544
4	Shyqyri	Kapllani	124/27	358	542	194036	3401	60000	257437
5	Halil	Halilaj	122/1	1717	542	930614	17170		947784
6	Musa	Kapllani	276/15	27	542	14634			34634
		Shuma				2713794	50750	80000	2844544

KËRKESË

Shtetasi Hetem Braho, i biri i Kamberit, i datëlindjes 1937, lindur dhe banues Kovacanj, Skrapar, kërkon shpalljen të vdekur të djalit të tij, Neim Braho.

KËRKUESI
Hetem Braho

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
 Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
 Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- | | |
|--|-----------|
| 1. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË | 600 lekë |
| 2. REGJISTRAT E NOTERISË | 1000 lekë |

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL	210 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE	332 lekë
KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)	542 lekë
KODI CIVIL	408 lekë
KODI I PROCEDURËS CIVILE	224 lekë
KODI I PUNËS	138 lekë
KODI I FAMILJES	244 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	88 lekë
• Vendime të Gjykatës Kushtetuese	700 lekë
• Vendime të Gjykatës së Lartë	1000 lekë
• Përmbledhje legjislacioni për nëpunësin civil	200 lekë
• Përmbledhje legjislacioni në fushën e tatimeve dhe taksave	273 lekë
• Përmbledhje e legjislacionit për pasuritë e paluajtshme (Vol. I -192 lekë; Vol. II – 168 lekë, Vol. III – 185 lekë)	

Hyri në shtyp më 1.4.2008
 Doli nga shtypi më 1.4.2008

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
 Tiranë, 2008

Çmimi 40 lekë